



National Endowment
for Democracy

Supporting freedom around the world



VLERËSIMI I STATUSIT TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE JQ-SHUMIÇË NË KOSOVË

2022

VLERËSIMI I STATUSIT TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOSOVË

Porositësi i hulumtimit

OJQ Aktiv

Autorë të hulumtimit

Caleb Waugh
Igor Marković

Donator

National Endowment for Democracy (NED)

Për botuesin

OJQ Aktiv

Adresa:

Mbreti Petar 183a, Mitrovicë Veriore

Dritan Hoxha 17, Prishtinë

E-mail: office@ngoaktiv.org

Uebsajti: www.ngoaktiv.org

Mitrovicë Veriore, nëntor 2022.

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	7
II. Pasqyrë e të drejtave në 2021.....	9
III. Procesi politik dhe zgjedhjet.....	21
IV. Qasja në shërbime.....	25
V. Çështjet socio-ekonomike.....	29
VI. Identiteti dhe trashëgimia kulturore.....	33
VII. Komunitetet e tjera jo-shumicë.....	35
VIII. Tre interesa kyç të secilit nga komunitetet jo-shumicë.....	37



Viti 2021 u shënua me një sërë trazirash, si në nivel global ashtu edhe në atë lokal, që patën ndikim thelbësor në rrjedhën e jetës socio-politike në Kosovë. Ndërkombëtarisht, pandemia e COVID-19 vazhdoi të përhapej me të madhe, por zbulimi i vaksinës premtoi dalje graduale nga një jetë që gjatë vitit të kaluar ishte shënuar dhe formësuar nga kufizime të ndryshme. Për më tepër, agji i presidencës së Joseph Biden sinjalizoi ndryshim kursi në politikën e jashtme të SHBA-së që kishte potencialin të ndikonte në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili doli në pah si shkëndijë e mundshme e përplasjes ndërmjet Rosisë dhe fuqive perëndimore. Brenda vendit, ngjarja e parë e madhe e vitit ishin zgjedhjet parlamentare të mbajtura në shkurt të atij viti, ku Albin Kurti mori pushtetin pas valës së pakënaqësisë popullore me status quo-në.¹ Partia e tij Vetëvendosje! fitoi 50% të votave direkte dhe arriti lehtësisht shumicën e vendeve në Kuvend, që ishte përmirësim shumë i madh në krahasim me mandatin e mëparshëm që zgjati vetëm disa muaj.²

Ngritja (e dytë) e Kurtit në detyrë si kryeministër u karakterizua nga një ton më agresiv në marrëdhëniet e qeverisë me Serbinë dhe komunitetin serb të Kosovës, gjë që shërbeu për të krijuar atmosferë shqetësimi në shumë sektorë të komuniteteve jo-shumicë të Kosovës. Për më tepër, premtimet për një 'dialog të brendshëm të drejtpërdrejtë' nuk u realizuan, gjë që mbase u përkeqësua më tej nga perceptimi se kabineti i Kurtit ishte i prirë për të ndërmarrë hapa të njëanshëm në mungesë pothuajse totale të konsultimeve paraprake me aktorët politikë jo-shumicë dhe/ose komunitetin ndërkombëtar. Rritja e vazhdueshme e numrit të incidenteve kriminale në komunitetet serbe të Kosovës nxiti rënie të shpejtë në masën në të cilën pjesëtarët e tyre shprehnin besim në situatën e sigurisë, duke përkeqësuar ndjesinë para-ekzistuese të mosndëshkimit. Në të njëjtën mënyrë, përdorimi i forcës nga ana e aktorëve të qeverisë në katër komunat veriore të Kosovës, pavarësisht nga arsyeja, la shumë pjesëtarë të komunitetit me ndjenjën se ishin targetuar padrejtësisht.

¹ KosSev, *Kosovski vanredni izbori uživo*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kosovski-vanredni-izbori-uzivo/>

² Politico, *Ousted Ex PM wins historic victory in Kosovo Election*, në dispozicion këtu: <https://www.politico.eu/article/ousted-ex-pm-wins-historic-victory-in-kosovo-election-albin-kurti/>

Pikërisht në këtë mjedis OJQ AKTIV filloi punën në edicionin e dytë vjetor të **Vlerësimit të statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë**. Duke përdorur format dhe metodologji të ngjashme me atë të përdorur për kërkimet e mëparshme, AKTIV u përpoq të qëndrojë në hap me zhvillimet që mund të ndikojnë potencialisht në implementimin e legjislacionit që rregullon të drejtat e komuniteteve dhe të matë masën në të cilën këto zhvillime sollën ndryshime të prekshme (qofshin pozitive apo negative) në praktikat institucionale. Në këtë drejtim, ajo që është mbase më e dukshme nuk është ndryshimi, por mungesa pothuajse totale e tij. Në fakt, dhe siç do të argumentohet gjatë gjithë rrjedhës së këtij publikimi, gjatë vitit 2021 situata u përkeqësua në shumë aspekte, pasi shumë mangësi institucionale të theksuara nga ky raport vitin e shkuar mbetën kryesisht të pa-trajtuara nga autoritetet përkatëse. Çështja e lidhjes së mundshme ndërmjet acarimit të retorikës publike, që përdoret kur diskutohet, për shembull, procesi i dialogut ose marrëdhëniet ndëretnike, dhe rritjes së incidenteve të sigurisë është e vështirë të konstatohet nga pikëpamja metodologjike, por fakti që shumë pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë ndihen më pak të mbrojtur dhe të sigurt për të ardhmen e tyre në Kosovë paraqet shkak për shqetësim në vijimësi.

Shumë nga çështjet e përshkruara më lart janë, para së gjithash, çështje të perceptimit dhe ndjenjave të publikut, që kanë dalë për shkak të ndryshimit të tonit dhe natyrës së deklaratave publike të bëra nga aktorët politikë, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Kur bëhet fjalë për aspektet 'themelore' të jetës së përditshme institucionale, situata ka mbetur thuajse në vendnumërim ngase këtë vit u vërejt e njëjta shkallë e moszbatimit të, për shembull, Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, siç ishte vënë re në vitin 2020. Qasja në shërbimet bazë vazhdoi të paraqitet si sfida, veçanërisht për ata qytetarë që jetojnë në komunitete më të vogla dhe më të izoluara. Zgjidhjet afatgjata për çështje të tilla si liria e lëvizjes, qasja në dokumentet e identitetit dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mbeten të pakapshme dhe shpesh të ngjyruara nga qëndrimet politike.

Vlerësimi i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë për vitin 2021 është publikim që, për dallim nga raportet e natyrës së ngjashme, synon të hedhë dritë mbi këndvështrimin e qytetarëve të thjeshtë mbi problemet me të cilat përballen çdo ditë apo kohë pas kohe dhe interesat që ata mendojnë se vendimmarrësit do të duhej t'i marrin parasysh më shumë. Në këtë drejtim, ekipi kërkimor ka realizuar katërmbëdhjetë (14) fokus grupe me pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë në komunat e Kosovës në të cilat ashkalinjtë, boshnjakët, egjiptianët, goranët, romët, turqit dhe serbët përbëjnë pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Përveç fokus grupeve me qytetarë, janë realizuar edhe tetëmbëdhjetë (18) intervista me përfaqësues të sektorit jo-qeveritar dhe mediave, si dhe me vendimmarrës nga radhët e komuniteteve jo-shumicë. Kjo qasje kërkimore kishte për qëllim eksplorimin e qëndrimeve dhe interesave personale të komuniteteve jo-shumicë, për të cilat ka diskutime shumë të kufizuara shoqërore dhe politike. Siç ishte rasti me raportin e vitit të kaluar, ky publikim do të shqyrtojë jetën e komuniteteve jo-shumicë për nga pjesëmarrja politike, qasja në shërbime, çështjet socio-ekonomike, identiteti dhe trashëgimia kulturore.

Informacionet kthyese të mbledhura nga këndvështrimi i qytetarëve të thjeshtë, por edhe i përfaqësuesve të shquar të komuniteteve jo-shumicë janë përfshirë në raport, qëllimi i të cilit është të informojë publikun si në Kosovë ashtu edhe në rajon për pengesat që hasin pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë. Është e rëndësishme të theksohet se ky raport nuk synon të mbulojë të gjitha çështjet dhe temat kryesore me rëndësi për komunitetet jo-shumicë, por të inkurajojë reagim nga institucionet qendrore dhe lokale, të cilat pa vonesë të mëtejshme do t'i merrnin më seriozisht faktet që do të paraqiten në këtë punim.

II. PASQYRË E TË DREJTAVE NË 2021

GJUHA DHE QASJA NË INFORMACION

Çështja e të drejtave gjuhësore, me fjalë të tjera, respektimi institucional i legjislacionit që rregullon dygjuhësinë zyrtare, në vitin 2021 mbeti një nga sfidat kryesore me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë. Ngurtësia e situatës buroir nga mungesa e vullnetit politik në vijimësi për të adresuar mangësitë institucionale në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe holistike dhe vazhdoi të ndikojë negativisht në aftësinë e shumë pjesëtarëve të komuniteteve të Kosovës për të funksionuar brenda strukturave institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes. Raportet e publikuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit³, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë⁴ dhe Komisioni Evropian të gjithë vërejtën probleme kur është fjala për respektimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Institucioni i Avokatit të Popullit gjithashtu theksoi se kishte marrë një numër ankesash nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë për shkak të mos respektimit të dygjuhësisë zyrtare.⁵ Ndërsa raportet ndryshojnë për nga toni, çështja e të drejtave gjuhësore në përgjithësi u theksua si një nga çështjet më urgjente me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë.

Gjatë vitit 2021 pati fare pak zhvillime për sa i përket të drejtave gjuhësore ndërsa situata mbeti kryesisht në vendnumërim. Pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë vazhduan të raportojnë sfida në marrjen e informacionit dhe shërbimeve në gjuhët e tyre amtare, veçanërisht në komunat që përndryshe janë me shumicë shqiptare. Në fakt, shumë nga ata që morën pjesë në intervista dhe fokus grupe shprehën mendimin se situata në fakt ishte përkeqësuar mes viteve 2020 dhe 2021, veçanërisht kur bëhej fjalë për kontaktet, bashkëpunimin dhe ofrimin e shërbimeve në nivel të qeverisjes lokale.⁶ Një i intervistuar tha se Qendra për Punë Sociale në Pejë ka raporte veçanërisht të dobëta me banorët vendas të nacionalitetit serb, ku punonjësit refuzojnë të komunikojnë dhe/ose të japin informacion në gjuhën serbe.⁷ Përshtypje dhe përvoja të ngjashme u vërejtën nga banorët serbë të Përluzhës (Komuna e Vushtrisë),⁸ and Osojanit (Komuna e Pejës). Në këto zona ankesë e shpeshtë është se punonjësit në institucionet lokale 'refuzojnë' të flasnin me ta në gjuhën serbe, ose se ata nuk u ofrojnë shërbimet e nevojshme. Në përgjithësi, ndjenja dhe konsensusi në mesin e pjesëmarrësve në kërkim nga komuniteti serb i Kosovës ishte ose se situata e përgjithshme mbeti e pandryshuar ndërmjet viteve 2020 dhe 2021 ose se ishte përkeqësuar, veçanërisht pas fitores së Albin Kurtit në zgjedhjet e shkurtit 2022.

³ State Department, *2021 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo, 2022*, available at: <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/kosovo/>

⁴ International Ombudsman Institute, *KOSOVO | Ombudsperson publishes Annual Report 2021, 2022*, available at: <https://www.theioi.org/ioi-news/current-news/ombudsperson-publishes-annual-report-2021#:~:text=The%20Ombudsperson%20Institution%20of%20Kosovo,1%20January%20%2D%2031%20December%202021.>

⁵ Ibid, pg. 80.

⁶ Based on interviews and focus groups conducted for the purposes of this research between August and October of 2022.

⁷ Interview with a Kosovo-Serb resident of Peja/Peć in September of 2022.

⁸ Based on a focus group conducted in Priluzhje/Përluzhë in August of 2022.

Mundësia e **komunitetit serb të Kosovës** për të realizuar qasje në shërbime dhe informacion pengohet në masë të konsiderueshme nga problemet e vazhdueshme strukturore kur bëhet fjalë për respektimin e legjislacionit dygjuhësh. Kjo është veçanërisht e dukshme në ndërveprimet e përditshme me institucionet në nivel të qeverisjes qendrore si dhe organet zyrtare lokale. OJQ AKTIV vazhdoi të vërejë probleme në përkthimin e njoftimeve zyrtare për shtyp, në uebsajtet e ministrive dhe uebsajtet e tjera zyrtare dhe në platforma si p.sh., 'eKosova'. Ndër këto, duhet theksuar se **Administrata Tatimore e Kosovës** ishte mbase një nga shkelësit më të rëndë gjatë vitit 2021, me formularë dhe udhëzime të shumta qoftë të padisponueshme në gjuhën serbe ose të përkthyer jashtëzakonisht dobët që shpesh përmbanin fjalë që nuk ekzistojnë në serbisht.⁹ Për më tepër, ndërsa portali online eKosova, i krijuar për të thjeshtuar proceset dhe procedurat e ndryshme administrative, në të vërtetë kishte versionin serbisht,¹⁰ u vunë re gabime të shumta gramatikore dhe leksikore, me disa seksione të përkthyer vetëm pjesërisht dhe/ose gabimisht.¹¹

Komuniteti boshnjak vëren probleme të ngjashme kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës në nivel institucional, veçanërisht në rajonet e Prizrenit dhe Pejës me rrethinë.¹² Siç është rasti edhe me gjuhën serbe, është raportuar se gjendja në aspektin e të drejtave gjuhësore (në nivel lokal) në fakt është përkeqësuar, dhe se Komuna e Prizrenit në veçanti nuk lëshon/ofron informacione në gjuhën boshnjake (pavarësisht faktit që gjuha boshnjake është 'gjuhë në përdorim zyrtar' në atë komunë). Për më tepër, pjesëmarrësit në hulumtim theksuan se autoritetet lokale, ndonjëherë, refuzojnë të komunikojnë me ta në gjuhën e tyre amtare. Një banor lokal i nacionalitetit boshnjak në Komunën e Prizrenit tha se, kur kishte raportuar një incident në lidhje me pronën personale, policia refuzoi t'i ofronte përkthim dhe i tha se: 'Ju boshnjakët duhet të mësoni shqip'. reporting an incident regarding their personal property, the police refused to provide them with translations and said that: 'You Bosniaks should learn Albanian'.¹³

Gazetarët e portaleve mediatike në komunitetin jo-shumicë vunë në dukje probleme të vazhdueshme dhe të shpeshta gjatë gjithë vitit 2021 lidhur me qasjen në informacion në **gjuhën serbe dhe boshnjake**, veçanërisht kur bëhej fjalë për përkthimet e njoftimeve për shtyp, deklaratave zyrtare dhe interpretimin gjatë konferencave për shtyp.¹⁴ Ky problem u diskutua gjerësisht në vitin 2020 kur mediat në gjuhën serbe raportuan se Qeveria e Kosovës nuk po publikonte informacione në gjuhën serbe, megjithëse disa gazetarë deklaruan se në fakt kishin vërejtur shkallë të caktuar përmirësimi në këtë drejtim. Ata gjithashtu vunë në dukje ngurrimin nga ana e aktorëve politikë dhe institucionalë si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror për të dhënë intervista, megjithëse u theksua gjithashtu se kjo është çështje me të cilën përballen edhe kolegët e tyre shqiptarë dhe për këtë arsye nuk është medoemos specifike për gazetarët nga komunitetet jo-shumicë.¹⁵ Sidoqoftë, vështirësitë me qasjen në informacione zyrtare, mungesa e shpeshtë e përkthimeve të komunikatave nga ministritë e nivelit qendror dhe Policia e Kosovës,

⁹ Bazuar në vizitat monitoruese në uebsajtin e Administratës Tatimore të Kosovës gjatë gjithë vitit 2021. (<https://www.atk-ks.org/sr/>)

¹⁰ Një shembull i kësaj është përdorimi i fjalës 'buton' në versionin serbisht të uebsajtit të Administratës Tatimore (<https://www.atk-ks.org/sr/>) në vend të fjalës së saktë 'dugme'.

¹¹ Bazuar në vizitat monitoruese në uebsajtin 'eKosova' (<https://ekosova.rks-gov.net/>) gjatë gjithë vitit 2021.

¹² Bazuar në fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit boshnjak ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

¹³ Po aty

¹⁴ Bazuar në intervistat me gazetarë të nacionalitetit serb, goran dhe boshnjak të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

¹⁵ Po aty

¹⁶ Based on interview conducted with journalists working for Radio Television Kosovo (RTK) in October of 2022.

i vendosin gazetarët nga komuniteti jo-shumicë në disavantazh krahasues, ngase u kërkohej të investojnë kohë dhe përpjekje shtesë për sigurimin e përkthimeve adekuate. Nga ana tjetër, gazetarët që punojnë për shërbimin në gjuhën serbe dhe boshnjake të Radio-Televizionit të Kosovës (RTK) deklaruan se kanë vërejtur përmirësime për sa i përket ofrimit të përkthimeve dhe se situata në RTK është e tillë që respektohet dygjuhësia zyrtare.¹⁶

Komunitetet tjera jo-shumicë, si **goranët, boshnjakët dhe romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët**, raportuan pengesa po aq të rënda për qasjen në informacion në gjuhët e tyre amtare, problem ky që është veçanërisht i shprehur në nivelin komunal, ku gjuhët shpesh kanë statusin e të qenit në përdorim zyrtar (si gjuha rome në Graçanicë), gjë që i detyron autoritetet të ofrojnë shërbime në ato gjuhë. Për shembull, nuk është ofruar pothuajse asnjë informacion në lidhje me vaksinat kundër COVID-19 në gjuhën gorane, rome, turke apo boshnjake. Për më tepër, faqe pak uebsajte zyrtare janë aktualisht të disponueshme në ndonjë nga gjuhët e lartpërmendura. Banorët që janë pjesë e **komunitetit turk** të Kosovës, veçanërisht ata që jetojnë në komunat jashtë Mamushës, theksuan raste të përsëritura të diskriminimit gjuhësor në nivel institucional. Kjo u kuptua se nënkupton mungesën e përkthyesve të punësuar në administratën komunale në Prizren (përfshirë takimet e mbajtura nga Zyra për Komunitete) dhe mungesën e informacionit zyrtar për komunikim të ofruar në gjuhën turke, ndër të tjera.¹⁷

Në fund të vitit 2021, mediat lokale raportuan se Komisioneri për Gjuhët (i cili punon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit) kishte përzgjedhur Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës si marrës të çmimit për Praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve¹⁸. Përzgjedhja e tyre shkaktoi reagim të fortë nga organizatat e shoqërisë civile serbe të Kosovës, të cilat përmendën mangësi të shumta në punën e të dy institucioneve në këtë drejtim, duke deklaruar se në thelb ishin shpërblyer praktikat e dobëta institucionale.¹⁹

Zhvillim pozitiv ishte shpallja e bërë në fillim të vitit 2021 se Universiteti i Prishtinës do të hapte Programin e Ballkanistikës²⁰ me mbështetjen dhe ndihmën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Ambasadës Britanike, që do të përfshinte kurse në gjuhën serbe për studentët. Ky u konsiderua si hap i rëndësishëm, pasi u pa si diçka që (në planin afatgjatë) ka potencial për të përmirësuar komunikimin ndëretnik dhe për të krijuar një gjeneratë të re dhe më të kualifikuar të përkthyesve dhe interpretuesve për punë në sektorin publik.

COVID-19

Gjatë gjithë vitit 2021, pandemia e COVID-19 vazhdoi të përbente sfida për autoritetet e shëndetit publik, duke ngarkuar shpesh spitalet dhe duke ndërprerë lëvizjen e lirë të mallrave dhe personave.

¹⁷ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit turk ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

¹⁸ KosSev, *Empirika: Preispitati odluku o dodeli nagrade za „Najbolju praksu u primeni Zakona o upotrebi jezika“*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/empirika-preispitati-odluku-o-dodeli-nagrade-za-najbolju-praksu-u-primeni-zakona-o-upotrebi-jezika/>

¹⁹ OJQ AKTIV, Komunikatë lidhur me ndarjen e çmimeve “Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve” institucioneve të Kosovës 2021, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/alb/news/statement-regarding-the-awarding-of-the-prize-of-best-practices-in-the-implementation-of-the-law-on-the-use-of-languages-to-institutions>

²⁰ KosSev, *The Balkanistics programme at the Faculty of Philology in Pristina awaits accreditation, Language Center to be opened*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/the-balkanistics-programme-at-the-faculty-of-philology-in-pristina-awaits-accreditation-language-center-to-be-opened/>

Edhe pse shumë masa, si kufizimet e brendshme në funksionimin e bizneseve, udhëtimet mes komunave dhe ndalimqarkullimi²¹ u hoqën gradualisht gjatë vitit 2020, Kosova vazhdoi të ballafaqohet me rritje periodike të numrit të rasteve.²² Sidoqoftë, konfuzioni fillestar mbi kërkesat e hyrjes dhe daljes u zbut deri diku nga kthimi i ngadalshëm, nëse jo i plotë, në normat para pandemisë. Megjithatë, dhe kjo do të shtjellohet në paragrafët pasues, zbulimi i vaksinës kundër virusit, si dhe pyetjet shoqëruese se si kjo do të ndryshonte dinamikën e situatës së përgjithshme, veçanërisht në aspektin e lirisë së lëvizjes, u dëshmuar si politikisht të paqëndrueshme dhe sërish shpërfaqën përçarje dhe mangësi në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe komuniteteve jo-shumicë të Kosovës.

Zbulimi i vaksinës kundër COVID-19, solli një epokë premtuese që la të kuptohet se po vinte fillimi i fundit të pandemisë globale që kishte shkaktuar çrregullim në pothuajse çdo nivel të jetës publike dhe private gjatë vitit të shkuar. Me gjithë euforinë e përbashkët për këtë lajm, politika, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, gradualisht bëri që të ndihej prania e saj pasi dalëngadalë u ngritën pyetje (logjistike dhe të tjera) se si dhe kujt do t'i shpërndaheshin dozat e vaksinave. Qeveria e Serbisë ishte e para në rajon, dhe ndër të parat në Evropë, që filloi administrimin e dozave të vaksinës (Pfizer) në dhjetor të vitit 2020.²³ Po atë muaj, qeveria serbe vuri gjithashtu në dispozicion vaksinat (gjithashtu Pfizer) për banorët e Kosovës të moshës 65 vjeç e lart.²⁴ Ky zhvillim u prit me njëfarë shqetësimi nga Qeveria e Kosovës, e cila u përgjigj duke konfiskuar vaksinat dhe duke ndaluar hyrjen e tyre në Kosovë, duke përmendur mungesën e pretenduar të koordinimit me Qeverinë e Serbisë.²⁵ Veçanërisht, Policia e Kosovës bastisi Qendrën Shëndetësore në Komunën e Shtërpcës, duke kërkuar stokun e vaksinave 'ilegale'.²⁶ Banorët vendas përmendën se ndiheshin të frikësuar nga ky veprim, si dhe shqetësime për qasjen në vakcina (në përgjithësi), veçanërisht kur Qeveria e Kosovës filloi me futjen e detyrimit për vaksinim dhe testim për hyrje në Kosovë.²⁷ Ndërsa kjo shkaktoi reagim të fortë nga Zyra e Kosovës dhe Metohisë, Qeveria e Serbisë më pas i ndërpreu përpjekjet e vaksinimit brenda Kosovës dhe në vend të kësaj hapi qendra posaçërisht për banorët e Kosovës në Rashkë (për Kosovën veriore), Kurshumli (Kosova perëndimore dhe qendrore) dhe Bujanoc (Kosova jugore).²⁸ Në të vërtetë, shumica dërrmuese e serbëve të Kosovës që u përcaktuan të marrin vaksinën e bënë këtë në Serbi, ku ata mund të regjistroheshin përmes portalin online eUprava.²⁹

²¹ KosSev, *Kosovska vlada: Ukinuta odluka kojom je ograničeno kretanje*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kosovska-vlada-ukinuta-odluka-kojom-je-ograniceno-kretanje/>

²² Kosovo Online, *EU sprema restriktivne mere za Kosovo i Severnu Makedoniju zbog pogoršane epidemiološke situacije*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.kosovo-online.com/koronavirus/eu-sprema-restriktivne-mere-za-kosovo-i-severnu-makedoniju-zbog-pogorsane-epidemioloske>

²³ Atlantic Council, *How Aleksandar Vučić stole the vaccine-diplomacy show*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/how-aleksandar-vucic-stole-the-vaccine-diplomacy-show/>

²⁴ OJQ AKTIV, *Vaksinimi në komunitetet e serbëve të Kosovës*, 2021, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/publication/vaccination-in-the-kosovo-system>

²⁵ Po aty

²⁶ KosSev, *Izvršen pretres u Domu zdravlja u Štrpcu, kosovske institucije tražile vakcine*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/izvršen-pretres-u-domu-zdravlja-u-strpcu-kosovske-institucije-trazile-vakcine/>

²⁷ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

²⁸ OJQ AKTIV, *Vaksinimi në komunitetet e serbëve të Kosovës*, 2021, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/publication/vaccination-in-the-kosovo-system>

²⁹ Ibid.

Për më tepër, u ofrua transport i organizuar për në dhe nga Serbia për pjesëtarët e komunitetit serb, goran, boshnjak dhe rom, ashkali dhe egjiptian.³⁰ Në përgjithësi, krahas homologëve të tyre serbë të Kosovës, pjesëtarët e **komunitetit goran** shfrytëzuan mundësitë e hershme për të marrë vaksinën në Serbi dhe shumica e atyre që u vaksinuan e bënë këtë atje, dhe jo në sistemin e Kosovës. Arsytet për këtë mund t'i atribuohen mungesës së komunikimit të qëndrueshëm ndërmjet atij komuniteti dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe pamundësisë për të pasur qasje në informacion lidhur me vaksinimin brenda sistemit institucional të Kosovës³¹ në gjuhë të tjera përveç shqipes. Këtu mund të vërehet një model i veçantë, pasi pjesëtarët e grupeve të tjera jo-shumicë (si p.sh **romët dhe boshnjakët**) bënë ankesa të ngjashme³². Një pjesë e kësaj mund t'i atribuohet njëfarë shkalle të pasivitetit nga ana e autoriteteve shëndetësore të Kosovës dhe autoriteteve të tjera relevante, pasi ata, të paktën pjesërisht, u nisën nga supozimi se serbët e Kosovës në veçanti do t'i merrnin vaksinat e tyre në Serbi. Sidoqoftë, kjo mund të shihet si pjesë e një modeli më të gjerë ku Qeveria e Kosovës nuk investon burime të mjaftueshme për të siguruar disponueshmërinë e informacionit thelbësor në gjuhë të tjera përveç shqipes. Situata për komunitetin boshnjak ishte deri diku ndryshe për shkak të shpërndarjes gjeografike, ku ata që jetonin në komunat si Prizreni i morën vaksinat e tyre në Kosovë dhe ata që banonin në katër komunat veriore i morën vaksinat në Serbi.³³ Sidoqoftë, pjesëtarët e komunitetit përmendën gjithashtu mungesën fillestare të koordinimit me institucionet e nivelit qendror si dhe varfërinë e informacionit të disponueshëm për ta në gjuhën boshnjake.³⁴ Pjesëtarët e komunitetit turk vunë në dukje se ata morën informacione për vaksinën, në përgjithësi, përmes mesazheve gojore dhe mesazheve telefonike nga Ministria e Shëndetësisë (në shqip) dhe përmes portaleve online. Për më tepër, u raportua se formularët dhe informacionet e tjera zyrtare nuk i ishin vënë në dispozicion atij komuniteti në gjuhën turke.³⁵ Pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë të cilët tentuan të caktojnë termin përmes portalit online eKosova raportuan ndërprerje të shpeshta dhe probleme të tjera teknike, megjithëse ky problem nuk ishte medoemos i përjetuar vetëm nga ata.³⁶ Në fund, këtu duhet theksuar se i njëjti mekanizëm (eKosova), i cili është një mjet qendror me gamë të gjerë për qasje në informacione dhe dokumente të caktuara dhe për të caktuar termin në institucionet qeveritare, është në dispozicion vetëm në serbisht, shqip, anglisht.³⁷ Po kështu, dhe në kohën e publikimit të këtij raporti, nënseksioni për caktimin e terminit për dozat e vaksinave është i disponueshëm vetëm në tri gjuhët e lartpërmendura.

Në komunitetin serb të Kosovës, debati rreth vaksinimit shpesh u mjegullua nga dezinformatat dhe dyshimet mjaft të përhapura, ku shumë banorë shprehën hezitim të hershëm për të marrë vaksinën, duke përmendur shpesh rezerva në lidhje me sigurinë e saj.³⁸ Kjo mund t'i atribuohet, të paktën pjesërisht, mungesës para-ekzistuese të besimit në mediat kryesore, institucionet qeverisëse dhe aktorët ndërkombëtarë si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara. Tendenca të ngjashme u vunë re në komunitetin goran³⁹.

³⁰ Po aty dhe bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

³¹ Bazuar në intervistat me pjesëtarë të komunitetit goran të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

³² Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komuniteteve të romëve, ashkalinjeve dhe egjiptianëve.

³³ Bazuar në intervistat me pjesëtarë të komunitetit boshnjak të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

³⁴ Po aty

³⁵ Bazuar në intervistat me pjesëtarë të komunitetit turk të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

³⁶ Po aty

³⁷ Shih: <https://ekosova.rks-gov.net/#>

³⁸ OJQ AKTIV, *COVID-19: Në mes të realitetit dhe dezinformatave*, 2020, në dispozicion në: <http://ngoaktiv.org/publication/covid-19-between-reality-and-disinformation>

³⁹ Bazuar në intervistat me pjesëtarë të komunitetit goran të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

Siç u përmend më parë, zbulimi i vaksinës ndryshoi dinamikën rajonale në drejtim të lëvizjes së lirë të mallrave dhe personave – pas një periudhe të gjatë kufizimesh në udhëtim, pritej gjerësisht se do të bëhej sërish i mundur udhëtimi pa kufizime për sa kohë që individit kishte marrë numrin e caktuar të dozave të njërës prej vaksinave të disponueshme. Futja fillestare e masave për hyrje që përfshinin parakushtin e vaksinës dhe/ose testimit gjatë gjithë vitit 2021 u prit shpesh me konfuzion dhe ankth, veçanërisht nga anëtarët e komunitetit **serb**.⁴⁰ Fakti që këto kërkesa të reja shpesh imponoheshin me fare pak paralajmërim (me kohë të kufizuar për t'u përgatitur për pajtueshmërinë e nevojshme), nënkuptonte ngritjen e shqetësimeve mbi kufizimet e reja të lirisë së lëvizjes, veçanërisht për ata banorë që nuk kishin marrë ende asnjë dozë të vaksinës. Për më tepër, u tha se kishte zënë rrënjë frika se masat e tilla do të shërbenin për të penguar apo parandaluar serbët nga marrja e vaksinës sepse ata nuk do të mund të ri-hynin në Kosovë menjëherë pas marrjes së dozës së parë.⁴¹ Megjithëse kërkesat e reja nuk ishin veçanërisht të ndryshme për nga natyra dhe përmbajtja nga vendet e tjera të rajonit, apo në të vërtetë në krahasim me Evropën në tërësi, fakti që kjo ndodhi në mungesë të komunikimit me komunitetet jo-shumicë shkaktoi një situatë pasigurie, veçanërisht për lëvizjen ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.⁴² Kjo mbase u rëndua edhe më shumë nga njoftimi i bërë në dhjetor të vitit 2021 se nga janari i vitit 2022, autoritetet kufitare të Kosovës do të fillonin të kërkojnë konfirmimin për dozën e tretë të vaksinës.⁴³ Përkundër gjithë kësaj, praktika shpesh ka devijuar nga udhëzimet administrative zyrtare, ku shumë banorë të pavaksinuar të Kosovës raportonin se kanë arritur të hyjnë lehtësisht, veçanërisht në vendkalimet veriore në Jarijë dhe Bërnjak.⁴⁴

RETORIKA PUBLIKE

Zgjedhja e Albin Kurtit në shkurt të vitit 2021 solli ndryshim të ndjeshëm në tonin dhe qëndrimin e retorikës publike në raport me komunitetet jo-shumicë të Kosovës, veçanërisht me serbët e Kosovës. Deklaratat e bëra nga aktorët politikë që përfaqësojnë komunitetin shqiptar të Kosovës, kryesisht Presidentja Vjosa Osmani, kishin ton dukshëm më të mprehtë në krahasim me pararendësit, me akuza të shumta drejtuar Serbisë, duke përfshirë se ajo duhet 'të përgjigjet për gjenocid', që ajo është 'burimi kryesor i destabilizimit në rajon' dhe se është 'kancer' për Evropën dhe se Kosova nuk do të formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.^{45 46 47} Efekti i kësaj në marrëdhëniet ndëretnike në nivelin themelor mbetet për t'u parë dhe sigurisht kërkon hulumtime të mëtejshme dhe më të hollësishme, por duket se shumë banorë të zonave të banuara me serbë, veçanërisht ata që jetojnë në jug të lumit Ibër,

⁴⁰ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës për qëllimet e këtij kërkimi ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁴¹ Po aty

⁴² Po aty

⁴³ Kosovo Online, *Oštrije mere za ulazak na Kosovo, od 3. januara sa potvrdom o revakcinaciji*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.kosovo-online.com/koronavirus/ostrije-mere-za-ulazak-na-kosovo-od-3-januara-sa-potvrdom-o-revakcinaciji-1-12-2021>

⁴⁴ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës për qëllimet e këtij kërkimi ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁴⁵ Irish Times, *Kosovo's new president says Serbia must answer for 'genocide'*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.irishtimes.com/news/world/europe/kosovo-s-new-president-says-serbia-must-answer-for-genocide-1.4537358>

⁴⁶ Presidente e Republikës së Kosovës, *Presidentja Osmani: Serbia dhe regjimi hegjemonist i Vuçiqit janë burimi kryesor i destabilizimit në rajon*, 2021, në dispozicion këtu: <https://president-ksgov.net/sq/lajme/presidentja-osmani-serbia-dhe-regjimi-hegjemonist-i-vuqiqit-jane-burimi-kryesor-i-destabilizimit-ne-rajon>

⁴⁷ N1, *Kosovo won't form CSM; Serbia is cancer of Europe, President says*, 2021, në dispozicion këtu: <https://rs.n1info.com/english/news/kosovo-wont-form-csm-serbia-is-cancer-of-europe-president-says/>

mendojnë se kjo është 'përhapur tutje' dhe 'reflektohet në marrëdhëniet lokale' në kuptimin që ata gjatë vitit 2021 vunë re ndryshime (negative) në mënyrën e qasjes dhe trajtimit të tyre nga autoritetet vendore.⁴⁸ Në vende të tjera që kanë zgjedhur qeveri me orientim politik nacionalist, janë identifikuar korrelacione të mundshme ndërmjet retorikës gjithnjë e më etno-centrike dhe rritjes së incidenteve të dhunës (verbale ose fizike).⁴⁹ Nëse kjo qëndron apo jo në rastin e Kosovës do të jetë veçanërisht e vështirë të përcaktohet në mënyrë empirike, por megjithatë është fushë që kërkon hetime të mëtejshme serioze për shkak të implikimeve për sigurinë e komuniteteve të cenueshme.

SIGURIA

Sipas raportit vjetor të Komisionit Evropian për progresin e Kosovës në procesin e aderimit,⁵⁰ gjatë vitit 2021, situata e sigurisë në komunitetet jo-shumicë në Kosovë ishte stabile, por u theksua posaçërisht rritja e numrit të incidenteve në zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës të cilët jetojnë në jug të lumit Ibër. Në veçanti, u theksuan rastet e grabitjeve, zjarrvënieve, vjedhjeve të bagëtive dhe automjeteve, si dhe lëndimeve trupore, rastet e përdorimit të armëve të zjarrit dhe tentativave për rrëmbim.⁵¹ Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2021, Grupi Qytetar për Veprim të Shpejtë (RRCG), i udhëhequr nga OJQ AKTIV, monitoroi nga afër zhvillimin e situatës së sigurisë në zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, por edhe në pjesë të Kosovës me prani të konsiderueshme të komuniteteve tjera jo-shumicë. Hulumtimi ka konstatuar se gjatë periudhës njëvjeçare në zonat me prezencë të theksuar të këtij komuniteti kanë ndodhur gjithsej 87 incidente në 25 komuna në mbarë Kosovën.⁵² Të dhënat e mbledhura nga OJQ AKTIV për sigurinë në komunitetet serbe janë përfshirë në raportin e Departamentit të Shtetit për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.⁵³ Bazuar në kategorizimin e incidenteve dhe metodologjinë e monitorimit të situatës së sigurisë të përkufizuar më parë, numri i përgjithshëm i incidenteve gjatë vitit 2021 ndahet si vijon:

- dëmtim/vjedhje e objekteve fetare dhe pronës së Kishës Ortodokse Serbe (KOS) (24),
- dëmtim/thyerje/grabitje e pronës familjare (21),
- sulme fizike (18),
- mbishkrime (grafite) provokuese (12),
- vjedhje/dëmtim i pasurisë së luajtshme private (6),
- vjedhje/dëmtim i pronës së institucioneve publike (6).

Përveç faktit se krahasuar me vitin 2020, është vërejtur rritje shqetësuese e numrit total të incidenteve (76 në total),⁵⁴ gjatë vitit 2021, RRCG regjistroi madje 18 raste më shumë se një vit më parë të dëmtimit/vjedhjes së objekteve fetare dhe pronës së KOS-së. Caqet më të shpeshta të vandalëve në këto raste ishin kishat, më saktë thyerja e tyre dhe më pas vjedhja e parave dhe materialeve me vlerë që ndodheshin në to.

⁴⁸ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës për qëllimet e këtij kërkimi ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁴⁹ Edwards, Griffin Sims and Rushin, Stephen, *The Effect of President Trump's Election on Hate Crimes*, 2018, në dispozicion këtu: <https://ssrn.com/abstract=3102652> apo <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3102652>

⁵⁰ Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën* 2021*, 2021, f. 36, në dispozicion këtu: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en

⁵¹ Po aty

⁵² OJQ AKTIV, *Incidentet e sigurisë në periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor, 2022*, në dispozicion këtu: <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/RRCG%20Incidentet%20e%20Sigurise.pdf>

⁵³ Departamenti i Shtetit, *Raporti i vitit 2021 për të drejtat e njeriut në Kosovë, 2022*, në dispozicion këtu: https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf

⁵⁴ OJQ AKTIV, *Vlerësimi i statusit të të drejtave të jo-shumicës në Kosovë, 2021*, f. 18, në dispozicion këtu: [http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo\(Alb\)web.pdf](http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo(Alb)web.pdf)

Përveç kësaj, janë regjistruar raste të përdhosjes së varrezave ortodokse (rrënimi i gurëve të varreve) në Gorazhdec (Komuna e Pejës)⁵⁵, Rahovec⁵⁶ dhe Fushë Kosovë.⁵⁷ Alarmues është edhe numri i rasteve të sulmeve fizike ndaj serbëve me përdorimin e armëve të ftohta apo armëve të zjarrit, si dhe të dhunës fizike (20 raste në vitin 2020; 18 në 2021). Përdorimi i armëve të zjarrit nga njësitë speciale ROSU dhe plagosja e një qytetari të Komunës së Zveçanit më 13 tetor 2021⁵⁸ shqetësoi veçanërisht qytetarët e nacionalitetit serb. Fokus grupet dhe intervistat e realizuara gjatë procesit të kërkimit për publikimin e sivjetshëm treguan se, krahasuar me vitet e shkuara, serbët e Kosovës e perceptojnë situatën e sigurisë në zonat e banuara nga pjesëtarët e këtij komuniteti si jashtëzakonisht të keqe. Ky pohim mbështetet edhe nga gjetjet e kërkimit të realizuar nga OJQ AKTIV në këtë komunitet për të gjashtin vit radhazi, të cilat treguan se perceptimi i situatës së sigurisë në Kosovë është duke u përqendruar dhe se vetëm në periudhën trevjeçare, përqindja e të anketuarve që besojnë se situata përqendrohet nga viti në vit është rritur me më shumë se 10%.⁵⁹ Sipas pohimeve të ekspertëve të sigurisë nga radhët e komunitetit serb, në ndryshimin e dukshëm të perceptimit të qytetarëve kanë ndikuar ndërhyrjet e shpeshta të njëjësive speciale policore në zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës^{60 61}, sidomos ato në veri të Kosovës,^{62 63} të cilat hasën në dënimin më të ashpër nga sektori joqeveritar i këtij komuniteti⁶⁴. Përveç kësaj, paralajmërimet për ndërtimin e bazës së supozuar më të madhe të FSK-së⁶⁵ në Kosovë në afërsi të komunave me shumicë serbe (në veri) po ashtu kanë ndikuar në zbehjen e perceptimit tashmë negativ të sigurisë personale dhe kolektive.⁶⁶

⁵⁵ Radio Goraždevac, *Uhapšena lica koja su opljačkala grobnicu u Goraždevcu*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.gorazdevac.com/2021/03/15/uhapsena-lica-koja-su-opljackala-grobnicu-u-gorazdevcu/>

⁵⁶ Gračanica online, *Kancelarija za KIM: Oskrnavljeno pravoslavno groblje u Orahovcu*, 2021, në dispozicion këtu: <https://gracanicaonline.info/2021/06/14/kancelarija-za-kim-oskrnavljeno-pravoslavno-groblje-u-orahovcu/>

⁵⁷ RTV KIM, *Kosovo Polje: Oskrnavljeni spomenici na groblju, deponija smeća na ulazu*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.radiokim.net/vesti/hronika/kosovo-polje-oskrnavljeni-spomenici-na-groblju-deponija-smeća-na-ulazu.html>

⁵⁸ Euronews Serbia, *Vatrenim oružjem ranjen Srećko Sofronijević iz Zvečana, operisan je i sada je na intenzivnoj nezi*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.euronews.rs/srbija/politika/20679/vatrenim-oruzjem-ranjen-srecko-sofronijevic-iz-zvecana-operisan-je-i-sada-je-na-intenzivnoj-nezi/vest>

⁵⁹ NVO AKTIV, *Analiza e trendit 2021: Qëndrimet e komunitetit serb në Kosovë*, 2021, f. 50, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/uploads/files/Analiza%202021%20Final%20Albanski.pdf>

⁶⁰ KosSev, *Nova akcija kosovskih specijalaca, RTV Puls: U Šilovu izvršen pretres dve srpske kuće*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/nova-akcija-kosovskih-specijalaca-u-silovu-izvršen-pretres-dve-srpske-kuće/>

⁶¹ Radio Goraždevac, *Uhapšeno 10 osoba u Štrpcu, među njima i bivši predsednik opštine*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.gorazdevac.com/2021/12/21/uhapseno-10-osoba-u-strpcu-medu-njima-i-bivsi-predsednik-opštine/>

⁶² Radio Slobodna Evropa, *Povredeni, uhapšeni i barikade na severu Kosova*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-sever-protesti-krijumcarenje/31506691.html>

⁶³ KosSev, *Posle dopremanja kontejnera, na Severu Kosova i specijalne jedinice*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/posle-dopremanja-kontejnera-na-severu-kosova-i-specijalne-jedinice/>

⁶⁴ KosSev, *Inicijativa OPEN: Upotreba specijalaca tokom kampanje dovodi do radikalizacije birača*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/inicijativa-open-ovakvi-postupci-lako-mogu-dovesti-do-otvorenog-konflikta-nesagledivih-razmera/>

⁶⁵ KosSev, *U Južnoj Mitrovici se gradi najveća baza KBS-a na Kosovu*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/u-južnoj-mitrovici-se-gradi-najveća-baza-kbs-a-na-kosovu/>

⁶⁶ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

Përkundër pretendimeve të Komisionit Evropian se Policia e Kosovës në përgjithësi vepron shpejt në rastet e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe pronës private dhe publike,⁶⁷ nga monitorimi i procesit të procedimit të veprave penale në 87 raste nga RRCG dhe OJQ AKTIV rezultoi se, ashtu si edhe vitet e shkuara, autoritetet gjyqësore dhe ato ligj-zbatuese nuk arritën të ushtrojnë kompetencat e tyre dhe të kenë qasje më proaktive në luftimin dhe procedimin e veprave penale. Së këndejmi, siç theksuan respondentët gjatë hulumtimit, niveli i mungesës së besimit tek institucionet po rritet dhe rrjedhimisht heqja dorë nga raportimi i këtyre rasteve. Është e rëndësishme të theksohet se gjatë viteve 2020 dhe 2021 nuk ka pasur dënime të incidenteve nga zyrtarët e nivelit qendror, veçanërisht atyre në rastet e sulmeve fizike. Si shembull i rrallë i përjashtimit nga kjo praktikë, mund të përmendet deputetja (dhe shefja e grupit parlamentar të partisë Vetëvendosje) Mimoza Kusari Lila, e cila dënoi sulmin fizik ndaj djaloshit në Gojbulë dhe kërcënimet ndaj të kthyerës Dragica Gašić nga Gjakova.⁶⁸

Si në vitet e shkuara, rastet e shpeshta të grabitjeve dhe vjedhjeve të pronës private në zonat kufitare të Komunës së Dragashit akoma mbeten kryesisht të pazgjidhura. Qytetarët **e nacionalitetit goran dhe boshnjak** theksuan faktin se ky problem vazhdon me dekada në këtë pjesë të Kosovës,⁶⁹ dhe thanë se për shkak të mungesës së reagimit adekuat dhe me kohë të institucioneve kompetente, popullata lokale nuk i raporton vjedhjet në një numër të madh të rasteve. Kjo vjen nga mosbesimi në reagimin e organeve ligj-zbatuese, por edhe, siç e kanë theksuar shpesh qytetarët,⁷⁰ kufiri me Shqipërinë është poroz dhe ka mungesë të patrullave kufitare që do të pengonin hyrjen e mundshme të atyre që, sipas tyre, kërcënojnë pronën e tyre private. Përkundër një sërë kërkesash të dorëzuara në Policinë e Kosovës për prani të shtuar të policëve në zonat kufitare të Komunës së Dragashit, kjo nuk ka ndodhur në vitin 2021. Po ashtu, qytetarët e kësaj komune më jugore shprehën frikën se besimi në njësitë e policisë lokale do të ulet ndjeshëm në periudhën e ardhshme, për faktin se gjatë vitit 2021 numri i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë të punësuar në organet e rendit është ulur në mënyrë drastike. **Boshnjakët** e Zhupës dhe të Podgorës vunë në pah rritjen e numrit të rasteve të grabitjeve të objekteve tregtare dhe xhamive në atë rajon dhe u ankuan për mungesën e plotë të ndjekjes penale të kryesve të veprave penale.

Respondentët **e nacionalitetit turk** theksuan se gjendja e sigurisë në bashkësi është e qetë, dhe se gjatë vitit 2021 dhe viteve të shkuara nuk kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti të rrezikimit të sigurisë dhe pronës. Përjashtimisht nga ky rregull, pjesëtarët e këtij komuniteti janë veçanërisht të shqetësuar për rritjen e numrit të fageve të internetit dhe profileve të rreme në rrjetet sociale nga të cilat dërgohen mesazhe fyese kundër turqve të Kosovës.⁷¹ Nga ana tjetër, pjesëtarët e komuniteteve të **romëve, ashkalinjve** dhe **egjiptianëve**, theksuan se janë viktima të shpeshta të shpërthimeve të dhunshme nga qytetarët e thjeshtë dhe se pothuajse në të gjitha rastet nuk e denoncojnë këtë lloj kërcënimi ndaj sigurisë private në polici apo në organet e drejtësisë. Siç pohojnë ekspertët nga këto komunitete, ky trajtim është tërësisht pasojë e diskriminimit dhe stigmatizimit të përgjithshëm, gjë që perceptohet si trajtim i pranueshëm në pjesë të caktuara të shoqërisë kosovare.⁷²

⁶⁷ Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën* 2021*, 2021, f. 36, në dispozicion këtu: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2021_en

⁶⁸ KosSev, Kusari Ljilja osudila napad na srpskog dečaka u Gojbulji i kritikovala peticiju protiv povratka Dragice Gašić, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kusari-ljilja-osudila-napad-na-srpskog-decaka-u-gojbulji-i-kritikovala-peticiju-protiv-povratka-dragice-gasic/>

⁶⁹ Kosovo Press, *Pljačke u Restelici ne prestaju, objijene dvije kuće*, në dispozicion këtu: <https://kosovo-press.info/2021/11/23/pljacke-u-restelici-ne-prestaju-obijene-dvije-kuce/>

⁷⁰ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

⁷¹ Po aty

⁷² Po aty

LIRIA E LËVIZJES

Ndryshe nga viti 2020, i cili u shënua me kufizime të shumta të lirisë së lëvizjes për shkak të pandemisë së COVID-19, qytetarët e Kosovës e pritën vitin 2021 në rrethana dukshëm më të çlirëta dhe të rregulluara më saktë nga aspekti ligjor. Rregullimi i udhëtimeve jashtë Kosovës, pas një sërë kritikash drejtuar Qeverisë për shkak të paqartësive dhe kufizimeve të përcaktuara më parë, u përshtat me tendencat evropiane për lehtësimin gradual të lirisë së lëvizjes në kushtet e stagnimit relativ të efekteve të pandemisë. Megjithatë, gjysma e dytë e vitit 2021 u shënua me rritje të numrit të të infektuarve, gjë që rezultoi me vendosjen e masave kufizuese me rastin e hyrjes dhe daljes nga Kosova. Përveç kësaj, fillimi i procesit të vaksinimit në Kosovë e ndërlikoi edhe më shumë zbatimin dhe interpretimin e atyre masave në lidhje me lirinë e lëvizjes. Përkatësisht, përveç ndalimqarkullimit që ishte në zbatim në vijimësi gjatë vitit në shqyrtim, u vendosën kufizime për hyrjen në Kosovë me kërkesën për të pasur patjetër certifikatë (ri)vaksinimi dhe/ose test antigen/PCR.

Në periudhën prej 30 gushtit deri më 12 shtator, qytetarët dhe personat me vendqëndrim të përkohshëm apo të përhershëm, të cilët nuk posedonin asnjë nga certifikatat e lartpërmendura, mund të hynin në Kosovë duke nënshkruar obligimin e vetizolimit për një periudhë prej shtatë (7) ditësh. Qytetarët e veriut të Kosovës që kanë udhëtuar nëpër Jarinjë dhe Bërnjak në atë periudhë, siç ka treguar hulumtimi, kanë hasur në interpretim paushall dhe arbitrar të masave të reja nga punonjësit e policisë dhe në shumë raste udhëtarëve që kishin të drejtën e përjashtimit nuk u ishte lejuar të ushtrjnë të drejtën e tyre të hyrjes me detyrimin e vetizolimit. Pas vendosjes së masave më të rrepta që hynë në fuqi më 6 dhjetor, hyrja në Kosovë praktikisht u kushtëzua me vaksinimin e plotë, gjë që për disa pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës (të cilët shpesh udhëtojnë për në Serbi) kufizoi ndjeshëm lëvizjen që për ta kishte rëndësi jetike. Gjatë procesit kërkimor të zhvilluar nga OJQ AKTIV, pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë theksuan se, ashtu si në vitin 2020, procesi i komunikimit ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve jo-shumicë në lidhje me marrjen e masave në luftën kundër pandemisë nuk ishte në nivel të kënaqshëm.

Përkundër paralajmërimeve të sektorit joqeveritar për problemet e mundshme që do të krijohë për pronarët e automjeteve me targa KS mosarritja e dakordimit për vazhdimin e Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe implikimeve që do të ketë për lirinë e lëvizjes në Kosovë,⁷³ Qeveria e Kosovës, pa u konsultuar me Beogradin dhe Brukselin, vendosi të pushojë vlefshmërinë e targave.⁷⁴ Krahasuar me vitin 2020, kur qytetarët ishin kryesisht të painformuar për këtë vendim,⁷⁵ pronarët e automjeteve me targa KS të cilët ishin bashkëbisedues dhe të anketuar gjatë hulumtimit theksuan se gjatë vitit 2021 pothuajse të gjithë qytetarët janë njoftuar për obligimin e ri-regjistrimit të targave KS në targa RKS nga mediat që publikojnë lajme në Kosovë në gjuhën serbe. Se vendimi për ri-regjistrim ishte kundërproduktiv për kufizimin e lirisë së lëvizjes, tregoi edhe vendimi i Qeverisë i marrë në shtator për vendosjen e targave të përkohshme,⁷⁶

⁷³ OJQ AKTIV, *Tabelat e shumëzimit të problemeve, 2021*, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/alb/news/multiple-number-plates-multiple-problems-22>

⁷⁴ Anadolu Agency, *Kosovo: Na graničnim prelazima počelo izdavanje privremenih tablica za vozila s registarskim tablicama Srbije, 2021*, në dispozicion këtu: <https://www.aa.com.tr/ba/balkan/kosovo-na-grani%C4%8Dnim-prelazima-po%C4%8Delo-izdavanje-privremenih-tablica-za-vozila-s-registarskim-tablicama-srbije/2369379>

⁷⁵ OJQ AKTIV, *Vlerësimi i statusit të të drejtave të jo-shumicës në Kosovë 2020, 2021*, f. 47, në dispozicion këtu: [http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo\(Alb\)web.pdf](http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo(Alb)web.pdf)

⁷⁶ RTV KIM, *Počelo izdavanje probnih RKS tablica, 2021*, në dispozicion këtu: <https://www.radiokim.net/vesti/politika/pocelo-izdavanje-probnih-rks-tablica.html>

gjë që krijoi pakënaqësi te qytetarët në veri të Kosovës duke ngritur barrikada.⁷⁷ Si pasojë e tensioneve që pasuan zbatimin e rregullimit për targa të përkohshme, Beogradi dhe Prishtina ranë dakord për rregullim të ri, që përfshinte vendosjen e afishes ngjitesë,⁷⁸ që u mirëprit nga qytetarët në masë të rezervuar si zgjidhje që gjithsesi lehtëson lirinë e lëvizjes, me vërejtjen se (sërish) mungesa e qasjes proaktive dhe me kohë për zgjidhjen e problemeve praktike i la qytetarët pa zgjedhje, d.m.th. pa të drejtën që të dëgjohet zëri i tyre për vendimmarrje (siç ishte rasti me shfuqizimin e vlefshmërisë së targave KS).

Me rastin e kremtimit të festës tradicionale gorane Dita e Shën Gjergjit, pjesëtarët e **komunitetit goran** të cilët udhëtuan me automjete me targa serbe në pjesën më jugore të Kosovës me qëllim të pjesëmarrjes në festë, hasën në trajtim të pabarabartë nga policia⁷⁹. Siç thonë ata, edhe pse nuk i kanë shkelur rregullat e trafikut, njësitet patrulluese kryesisht kanë ndaluar dhe kontrolluar në hollësi veturat pronarët e të cilave jetojnë dhe punojnë në Serbi.⁸⁰ Respondentët theksuan se nuk kanë pasur kësi lloj trajtimi gjatë vitit 2021, gjë që i ka çuar në përfundimin se ky përjashtim ka lindur nga tensionet që ishin aktuale lidhur me zgjidhjen e çështjes së përdorimit të targave të lëshuara nga MPB e Serbisë në Kosovë. Për këto raste nuk është bërë asnjë denoncim në polici.

Banorët e **nacionalitetit boshnjak** në zonat rurale të Komunës së Prizrenit u ankuan për mungesën e patrullave të rregullta policore, të cilat do të ofronin siguri shtesë për popullatën lokale. Kjo e fundit buron nga pohimet e qytetarëve të kësaj pjese të Kosovës se nuk ndihen të sigurt gjatë orëve të natës dhe se gjatë asaj periudhe nuk praktikojnë daljen nga shtëpitë e tyre (sidomos me fëmijë) për shkak të ardhjeve të pretenduara të "personave të panjohur" që "nuk ngjallin besim" te popullata vendase.⁸¹ Edhe pse në fshatin Reçan ka një nënstacion policor, qytetarët pohojnë se aktiviteti i tij është jashtëzakonisht i ulët, përkundër kërkesave për patrullim në rrugët kryesore të fshatit.

⁷⁷ VOA, *Serbs Lift Roadblocks in Kosovo as NATO Moves to End License Plate Row*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.voanews.com/a/serbs-lift-roadblocks-in-kosovo-as-nato-moves-to-end-license-plate-row/6254637.html>

⁷⁸ KosSev, KP: *Počelo sprovođenje sporazuma o nalepnicama na svim prelazima*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kp-pocelo-sprovođenje-sporazuma-o-nalepnicama-na-svim-prelazima/>

⁷⁹ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

⁸⁰ Po aty

⁸¹ Po aty

III. PROCESI POLITIK DHE ZGJEDHJET

Përkundër faktit se zgjedhjet për Kuvend u mbajtën në shkurt 2021, Ekipi Kërkimor i OJQ AKTIV vendosi të përfshijë analizën e rezultateve të zgjedhjeve në raportin e publikuar për Vlerësimin e statusit të drejtave të komuniteteve jo-shumicë për vitin 2020 të publikuar në vitin 2021. Arsyeja prapa kësaj ishte se pjesa më e madhe e fushatës politike filloi përpara janarit 2021, duke ndikuar në dinamikën socio-politike në komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Prandaj, rekomandohet që lexuesit të konsultohen me publikimin e vitit të kaluar, i cili përfshin një analizë të thellë të zgjedhjeve të parakohshme të vitit 2021 dhe ndikimin e tyre në përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në Kuvend.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, njëzet (20) vende janë të rezervuara për përfaqësuesit politikë të komuniteteve jo-shumicë, ku shumica (dhjetë) shkojnë për serbët e Kosovës. Pas zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2021, komunitetet jo-shumicë përfaqësohen nga dhjetë parti të ndryshme, njëra është serbe (Lista Srpska), tre boshnjake, një gorane, katër rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe një turke. Në përgjithësi, pjesëmarrja (48.78%) ishte relativisht e ulët sipas standardeve evropiane, por gjithsesi një përmirësim prej 4% në krahasim me zgjedhjet e mëparshme parlamentare.⁸² Raportet e vëzhgimeve vunë re pjesëmarrje energjike nga ana e komuniteteve jo-shumicë, me rritje të veçantë nga ana e pjesëtarëve të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.⁸³

- Lista Srpska (komuniteti serb) – 10 ulëse
- Partia Demokratike Turke e Kosovës (komuniteti turk) – 2 ulëse
- Koalicioni Vakrat (komuniteti boshnjak) – 1 ulëse
- Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (komuniteti egjiptian) – 1 ulëse
- Iniciativa Rome (komuniteti rom) – 1 ulëse
- Partia e Re Demokratike (komuniteti boshnjak) – 1 ulëse
- Unioni Social Demokrat (komuniteti boshnjak) – 1 ulëse
- Partia e Bashkuar Gorane (komuniteti goran) – 1 ulëse
- Partia e Ashkalinjve për Integritim (komuniteti ashkali) – 1 ulëse
- Iniciativa Qytetare – Lëvizja Progressive e Romëve të Kosovës – 1 ulëse

Zgjedhjet lokale u mbajtën më 17 tetor 2021 në komunat anembanë Kosovës, gjatë së cilave banorët votuan për kryetarë komunash dhe këshilltarë komunalë. Nga të gjitha ulëset e hapura për garë gjatë zgjedhjeve, 191 i fituan përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë, ku rreth 145 prej tyre ishin serbë të Kosovës, dhe 44 ulëse i fituan pjesëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë.⁸⁴ Për sa i përket pjesëmarrjes, u raportua se pjesëmarrja e përgjithshme ishte 43%, por dukshëm më e lartë në komunat me shumicë serbe, ku mesatarisht ishte 61%.⁸⁵

⁸² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

⁸³ National Democratic Institute (NDI), *Post-Election Analysis of February 14, 2021 Parliamentary Election*, 2021. fq. 8., "Të dhënat e KQZ-së treguan rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së komunitetit rom dhe komunitetit boshnjak në zgjedhjet e vitit 2021, krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore, si dhe shumë vota të ardhura nga komunat me shumicë serbe të Kosovës. "Komuniteti i Bashkuar", partia e sapoformuar boshnjake në veri të Mitrovicës, mori 83 për qind të votave të veta nga komunat serbe, duke fituar një ulëse, ndërsa "Iniciativa Rome" e sapoformuar siguroi 60 për qind, duke marrë dy ulëse në Kuvend.

⁸⁴ National Democratic Institute (NDI), *Kosovo's 2021 Local Elections: Analysis of Inclusion and Information Integrity*, 2021. fq. 9, në dispozicion këtu: <https://www.ndi.org/sites/default/files/Kosovo%27s%202021%20Local%20Elections%20-%20NDI%20Analysis%20of%20Inclusion%20and%20Information%20Integrity.pdf>

⁸⁵ Bashkimi Evropian, *Misioni i vëzhgimit të Zgjedhjeve, Kosovë 2021: Raporti Përfundimtar (Zgjedhjet Komunale)*, 2021. fq. 17, në dispozicion këtu: <https://www.eods.eu/library/Final%20Report%202021%20EOM%20Kosovo%20municipal%20elections%20-%20ALBANIAN.pdf>

Dhjetë (10) përfaqësues të porsazgjedhur të komunitetit serb të Kosovës (të gjithë anëtarë të partisë Srpska Lista) dhe një (1) nga komuniteti goran (Partia e Bashkuar Gorane) parashtuan ankesë të përbashkët në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar sqarimin e procedurave dhe mënyrës se si emërohen ministrat që përfaqësojnë interesat e komuniteteve jo-shumicë në Qeveri. Kjo ankesë u arsyetua me faktin se kryeministri Kurti emëroi vetëm një (1) ministër nga komuniteti serb i Kosovës, vendim ky që pretendohet se ishte në kundërshtim me normën kushtetuese. Gjysmë viti më vonë, Gjykata konstatoi se Vendimi i kontestuar i Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë nuk ishte në kundërshtim me paragrafët 3 dhe 5 të nenit 96 të Kushtetutës. Vendimi i Gjykatës ishte bazuar në faktin se Kushtetuta përcakton që kandidati për kryeministër ka diskrecion në emërimin e ministrave nga komunitetet jo-shumicë në rastet kur një Qeveri ka më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, gjë që rrjedhimisht e detyron Qeverinë të propozojë një të ashtuquajtur ministër 'të tretë' nga një komunitet jo-shumicë. Në rastet kur kandidati i propozuar për postin e 'tretë' ministror është tashmë deputet i zgjedhur në Kuvend, atëherë kandidati nuk është e thënë të jetë serb i Kosovës.

PJESËMARRJA NË PROCESET POLITIKE DHE PËRFAQËSIMI POLITIK

Në një masë të caktuar, komunitetet jo-shumicë ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të qeverisë: që nga viti 2021, një zëvendëskryeministre (Emilija Redžepi) është me kombësi boshnjake, ndërsa një numër ministrash, përfshirë Ministrin për Komunitete dhe Kthim (Goran Rakić), gjithashtu vijnë nga komunitetet jo-shumicë.⁸⁶ Me fjalë të tjera, në vitin 2021, tri (3) pozita në nivel kabineti nga gjithsej 18 janë mbajtur nga pakicat. Kjo, natyrisht, duke mos marrë parasysh përfaqësimin në Kuvend dhe pozitat e zëvendësministrave. Në të njëjtën kohë, duket se ekziston një nivel i dukshëm i pakënaqësisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në lidhje me efektivitetin e përfaqësimit të tyre politik.⁸⁷ Për shembull, pjesëmarrësit në një fokus grup të mbajtur me **boshnjakë** në rajonin e Prizrenit, thanë që ndienin se aktorët politikë nga komuniteti i tyre, përkundër faktit se ishin të pranishëm dhe aktivë në skenën e përgjithshme politike, në përgjithësi nuk arritën të angazhohen në mënyrë efektive për interesat e komunitetit.⁸⁸ Pjesëtarët e **komunitetit goran** shprehën ndjenja të ngjashme, duke përmendur shpesh përshtypjen se politikanët kanë tendencë të injorojnë ose të shtypin 'problemet reale', duke u përcaktuar që t'i përdorin ato për përfitimin e tyre politik dhe jo për atë të komunitetit në përgjithësi.⁸⁹ Kjo ambivalencë dhe ndjenja e përgjithshme e pakënaqësisë me efektivitetin e përfaqësimit të tyre politik u reflektuan edhe në bisedat me pjesëtarët e **komunitetit turk**, të cilët vunë në dukje nivelin e lartë të pjesëmarrjes dhe premtimet e gamës së gjerë gjatë fushatës parazgjedhore në fillim të vitit 2021, të cilat në masë të madhe nuk u realizuan.⁹⁰

⁸⁶ Elbert Krasniqi, nga komuniteti egjiptian i Kosovës, është ministër i administrimit të pushtetit lokal.

⁸⁷ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet me pjesëtarë të komuniteteve serbe, boshnjake, gorane, turke dhe rome, ashkali dhe egjiptiane të kryera ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁸⁸ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit boshnjak ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁸⁹ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit goran ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁹⁰ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit turk ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

Në një aspekt më pozitiv, pjesëtarët e komunitetit boshnjak në Prizren dhe rrethinë, nivelin më të lartë të përfaqësimit institucional dhe politik që erdhi me administratën e dytë të Kurtit nga shkurti i vitit 2021, e panë si fillim të një epoke të re të mundësive për disa të rinj përmes prezantimit të skemave të praktikës së punës të dedikuara për komunitetin e tyre⁹¹.

Kur është fjala për **serbët e Kosovës**, klima e përgjithshme politike është disi e ndërlikuar nga kompleksiteti i pozicionit të tyre ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Konkurrenca për sa i përket zgjedhjeve është më e vogël sesa në komunitetet e tjera jo-shumicë: përkundër faktit se serbët e Kosovës përbëjnë grupin më të madh jo-shumicë në Kosovë, ai ka vetëm një parti që e përfaqëson atë në nivelin qendror, dhe e cila është dominuese në masë dërrmuese në komunat me shumicë serbe.⁹² Si shembull për këtë, gjatë zgjedhjeve lokale të tetorit 2021, Lista Srpska fitoi, në disa komuna, mbi 90% të votave.⁹³ Duke e pasur parasysh këtë, opinionet ndaj aktorëve politikë janë shumë të formësuara nga konteksti socio-politik që është nën hijen e çështjeve të tilla si procesi i dialogut Beograd-Prishtinë dhe jo nga çështjet lokale me të cilat përballet komuniteti serb i Kosovës.⁹⁴ Siç është rasti me komunitetet tjera, serbët në Kosovë shpesh shprehin mendimin se përfaqësimi i tyre politik nuk i artikulon nevojat e tyre në mënyrë efektive në nivel politik,⁹⁵ qëndrim ky që është veçanërisht i fortë në komunitetet serbe të Kosovës në jug të lumit Ibër.⁹⁶ Serbët që jetojnë në komunitete dhe enklava më të vogla, veçanërisht në Kosovën perëndimore, kanë tendencë shumë më të madhe për të ndier se janë 'lënë pas' ose 'injuar' nga politikanët sesa homologët e tyre në veri të Kosovës.⁹⁷

⁹¹ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit boshnjak ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁹² Anadolu Agency, *Kosovo: Objavljani konačni rezultati prvog kruga lokalnih izbora za načelnike i gradonačelnike*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.aa.com.tr/ba/politika/kosovo-objavljani-kona%C4%8Dni-rezultati-prvog-kruga-lokalnih-izbora-za-na%C4%8Delnike-i-gradona%C4%8Delnike/2405536>

⁹³ Anadolu Agency, *Kosovo: Objavljani konačni rezultati prvog kruga lokalnih izbora za načelnike i gradonačelnike*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.aa.com.tr/ba/politika/kosovo-objavljani-kona%C4%8Dni-rezultati-prvog-kruga-lokalnih-izbora-za-na%C4%8Delnike-i-gradona%C4%8Delnike/2405536>

⁹⁴ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

⁹⁵ Po aty

⁹⁶ Po aty

⁹⁷ Po aty

ARSIMI

Një nga efektet më të dukshme dhe me të vërtetë tronditëse të mbylljes për shkak të COVID-19 ishte ndikimi i tij në arsim, si dhe debatet që pasuan se kur dhe në çfarë kushtesh të rihapen shkollat. Përveç kësaj, koncepti i 'mësimit në distancë' i cili kërkonte zotërimin dhe qasjen në teknologjinë e nevojshme për një ndërmarrje të tillë shpërfaqti pabarazitë (shpesh të mëdha) socio-ekonomike. Ndonëse shkollat filluan të rihapen në Kosovë në vjeshtën e vitit 2020,⁹⁸ ato ishin subjekt i mbylljeve periodike (për shkak të luhatjeve në numrat e rasteve të COVID-19) deri në gjysmën e dytë të 2021.⁹⁹ Vështirësive arsimore iu shtuan pyetjet nëse shkollat që funksionojnë nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë do t'u përmbaheshin udhëzimeve të nxjerra nga Qeveria e Kosovës ose e Serbisë, ndërsa situata që rezultoi ishte disi e përzier, ku masat (d.m.th., mbylljet e shkollave) ishin shpesh hibrid i dy sistemeve.

Në përgjithësi, komunitetet të cilat në vitin 2021 u përballën me sfidat më të mëdha për sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, dhe vazhdojnë të përballen me to edhe sot e kësaj dite, ishin **komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve**. Ata u përballën me probleme për sa i përket infrastrukturës fizike të shkollave që vijnë, si dhe mungesës së stafit dhe pamundësisë së shkollave të drejtuara nga qeveria për të ofruar mjedis të përshtatshëm mësimi, veçanërisht gjatë periudhave të ndalimqarkullimit.¹⁰⁰ Pavarësisht përpjekjeve zyrtare për t'i trajtuar këto çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse, ato ende nuk kanë dhënë fryte.¹⁰¹ Kërkimet tregojnë se nxënësit nga **komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve** përbëjnë 3-5.5% të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme,¹⁰² por janë dukshëm prapa bashkëmoshatarëve të tyre për sa i përket arritshmërisë së mësimit për grupmoshat e tyre.¹⁰³ Mundësia për të krijuar një pamje më të plotë të gjendjes së arsimit në komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve komplikohet më tej nga fakti se shumë vijnë shkollat brenda sistemit serb, veçanërisht ata që jetojnë në komunat e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Obiliqit.^{104 105}

⁹⁸ Balkan Insight, *NEWS Some Balkan, Central European States Open Schools Despite COVID-19*, 2021, në dispozicion këtu: <https://balkaninsight.com/2020/09/01/some-balkan-central-european-states-open-schools-despite-covid-19/>

⁹⁹ Radio Free Europe, *Kosovo Delays Start Of School Year Amid Rise In COVID Cases*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.rferl.org/a/kosovo-schools-delay-covid/31433978.html>

¹⁰⁰ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet me pjesëtarë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të realizuara ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

¹⁰² Action for Reducing Inequalities in Education, *Policy Brief: Kosovo*, 2021, në dispozicion këtu: https://www.arisenetwork.eu/media/filer_public/08/b4/08b40e8a-ef4e-4b45-9013-9f7226114f56/policy_brief_kosovo_eng.pdf

¹⁰³ Po aty

¹⁰⁴ Varësisht nga njohuritë e gjuhës serbe, së bashku me faktorë të tjerë, disa fëmijë romë vijnë të ashtuquajturat 'shkolla rome', ndërsa të tjerët vendosen në shkolla krahas bashkëmoshatarëve të tyre serbë të Kosovës.

¹⁰⁵ Kosovo 2.0, *SHKOLLA FANTAZMË, SHKOLLA GETO E NDËRRIME TË SEGREGUARA*, në dispozicion këtu: <https://kosovotwopointzero.com/shkolla-fantazme-shkolla-geto-e-nderrime-te-segreguara/>

Pjesëtarët e komuniteteve të tjera, si **goranët dhe boshnjakët**, përmendin mungesën e investimeve të mjaftueshme financiare dhe burimore në arsim në komunitetet e tyre. Kjo është veçanërisht e vërtetë në komunitetet rurale dhe të izoluar, ku ka prirje që shkollat lokale të jenë të pafinancuara dhe me staf të pamjaftueshëm.¹⁰⁶ Një model i ngjashëm mund të vërehet edhe në komunitetet e tjera jo-shumicë, të cilët përmendin mungesën e teksteve shkollore në dispozicion si dhe vëmendjen e pamjaftueshme që i kushtohet mësimi të gjuhës.¹⁰⁷ Përveç kësaj, pjesëtarët e **komunitetit turk** vunë në dukje që nuk kanë libra të mjaftueshëm në gjuhën turke si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme, por edhe faktin se ka mungesë të madhe të interesimit për mësimin e turqishtes si lëndë akademike.¹⁰⁸

Serbët e Kosovës që jetojnë në zonat rurale vazhdojnë të jenë të preokupuar me probleme që lidhen me mundësinë e shkollave lokale për të rekrutuar mësimdhënës dhe për t'u ofruar nxënësve burime të përshtatshme mësimore, gjë që është veçanërisht e dukshme në fshatrat më të izoluar.¹⁰⁹ Për më tepër, si problem i përgjithshëm me të cilin përballen shkollat serbe në Kosovë vazhdojnë të jenë vështirësitë me të cilat ballafaqohen në importimin e teksteve shkollore dhe materialeve tjera të ngjashme mësimore nga Serbia.

KUJDESI SHËNDETËSOR

Ofrimi i shërbimeve për komunitetet jo-shumicë, komuniteteve të cënueshme dhe komuniteteve që jetojnë në vendbanime të largëta gjatë vitit 2021 ishte një nga sfidat kryesore gjatë pandemisë së COVID-19. Pengesat dhe problemet me të cilat u përballën qytetarët e këtyre kategorive sociale në periudhën para pandemisë u shumëfishuan gjatë viteve 2020 dhe 2021, duke e vështirësuar ndjeshëm qasjen në shërbimet më të nevojshme. Kapacitetet e kufizuara të sistemit shëndetësor në Kosovë në mënyrë të konsiderueshme i kanë pamundësuar pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, si dhe qytetarët tjerë, të kenë qasje në shërbimet e kujdesit mjekësor dhe shërbimet mbrojtëse shëndetësore. Vonesat në prokurimin e numrit të mjaftueshëm të vaksinave dhe testeve, numri i pamjaftueshëm i personelit profesional mjekësor, problemet e trashëguara të infrastrukturës janë vetëm disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi shëndetësor në Kosovë, të cilat kanë prekur njësoj pothuajse të gjitha komunitetet.

Pjesëtarët e komunitetit serb që shfrytëzojnë shërbimet e sistemit shëndetësor të financuar nga Ministria e Shëndetësisë së Serbisë në Kosovë theksuan se gjatë vitit në shqyrtim, automjetet e shërbimeve mjekësore që operojnë në kuadër të këtij sistemi shumë herë janë ndaluar nëpër vendkalime, me kontroll shpeshherë rigoroz të automjeteve dhe personelit mjekësor.¹¹⁰ Në pengesa të ngjashme kanë hasur edhe transportuesit e shërbimeve funerale, të cilët me të hyrë në Kosovë janë ndaluar për disa orë për shkak të pohimeve të policisë se është i ndaluar transportimi i të ndjerëve në kushte pandemie.¹¹¹

¹⁰⁶ Based on interviews and focus groups conducted between August and October of 2022.

¹⁰⁷ Ibid.

¹⁰⁸ Ibid.

¹⁰⁹ Ibid.

¹¹⁰ Based on interviews and focus groups conducted for the purposes of this research in the period from August to October 2022.

¹¹¹ Ibid.

¹¹² NGO AKTIV, *Vaccinations in Kosovo Serb communities*, 2021, available at: http://ngoaktiv.org/uploads/files/Work%20ENG_compressed.pdf

Qasja në vaksina në Serbi ishte e disponueshme për të gjithë personat që posedonin librezë shëndetësore të lëshuara nga Fondi Republikan i Sigurimeve Shëndetësore, e drejtë kjo që u shfrytëzua edhe nga pjesëtarët e **komuniteteve të goranëve, romëve dhe shqiptarëve**¹¹².

Gjatë pandemisë **romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët** u përballën gjithashtu me diskriminim dhe qasje të kufizuar kur përpqeshin të realizojnë qasje në shërbime shëndetësore dhe të sigurimeve shëndetësore, gjë që i marginalizoi më tej në krahasim me komunitetet e tjera në Kosovë. Kushtet e pakënaqshme të funksionimit të sistemit shëndetësor gjatë pandemisë e thelluan problemin e cënueshmërisë së këtij komuniteti për nga aspekti i qasjes në kujdesin shëndetësor. Krahas trajtimit jo të mirë nga personeli mjekësor, pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë hasur në raste të refuzimit për të ofruar shërbime në spitale dhe klinika të shërbimeve ambulatorë pa dhënien e shpjegimeve të vlefshme. Si një nga problemet që ekspertët e këtyre komuniteteve e theksojnë si vendimtar dhe që kërkon ndryshim urgjent në praktikën e institucioneve shëndetësore, është përmirësimi i cilësisë së kujdesit prenatal, i cili, sipas tyre, pjesëtarëve të këtyre komuniteteve u ofrohet më keq krahasuar me të tjerët.

Boshnjakët të cilët jetojnë në zonat e Zhupës dhe Podgorës nuk kanë pasur qasje adekuatë në kujdesin mjekësor dhe kujdesin shëndetësor primar edhe gjatë vitit 2021, për shkak të mungesës së personelit mjekësor, dhe shumë janë detyruar të kërkojnë ndihmë në Prizren, gjë që ka sjellë kosto shtesë financiare. Përkundër thirrjeve të komuniteteve lokale drejtuar Komunës së Prizrenit për ta trajtuar këtë problem, nuk u arrit zgjidhje gjatë vitit në shqyrtim. Goranët të cilët jetojnë në zonat e largëta të populluara të Komunës së Dragashit, gjatë muajve të dimrit kanë pasur vështirësi me qasjen në shërbimet shëndetësore dhe shërbimet tjera për shkak të rrugëve të mbuluara me borë të cilat, sipas pohimeve të popullatës lokale, nuk janë pastruar rregullisht dhe me kohë.

IDENTITY DOCUMENTS

Në vitin 2021, çështja e qasjes në dokumentet e identitetit dhe shtetësisë vazhdon të jetë çështje shqetësuese, veçanërisht për pjesëtarë të caktuar të **komuniteteve të serbëve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve**. Një nga burimet kryesore të këtij problemi janë udhëzimet administrative¹¹³ të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme, të cilat përshkruajnë udhëzimet në përputhje me Ligjin për Shtetësinë që rregullon rrethanat në të cilat mund të merret shtetësia dhe cilat dokumente nevojiten për plotësimin e procedurave përkatëse. Një numër i individëve të intervistuar dhanë mendimin e tyre se këto udhëzime (me sa duket) kanë krijuar bllokadë administrative për shumë qytetarë që dëshirojnë të marrin dokumentet e identitetit të Kosovës,¹¹⁴ veçanërisht banorët më të rinj që kanë lindur jashtë Kosovës (d.m.th., në Serbi).¹¹⁵

¹¹³ Ministria e Punëve të Brendshme, *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 05/2020 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E FITIMIT TË SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, 2020.*

¹¹⁴ Një nga shkaqet e kësaj është me sa duket neni 7 i Udhëzimit Administrativ (Fitimi i shtetësisë me lindje jashtë territorit të Republikës së Kosovës kur njëri prind ka shtetësi tjetër) pasi kërkon që të DY prindërit e aplikuesve 'të pajtohen' që fëmija të marrë shtetësinë.

¹¹⁵ Bazuar në informacionin e mbledhur gjatë kërkimeve në terren të kryera nëpër zonat e banuara me serbë të Kosovës. Tri (3) raste janë konfirmuar përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me personat e përfshirë.

Kërkimet e kryera për qëllimet e këtij raporti vunë në dukje një numër (relativisht) të madh të serbëve të Kosovës, veçanërisht atyre që jetojnë në jug të lumit Ibër, të cilëve u është mohuar qasja në shtetësi dhe të cilët nuk kanë qenë në gjendje ta trajtojnë në mënyrë efektive këtë çështje. Një i intervistuar deklaroi se, sipas mendimit të tyre, vetëm në Gorazhdevc ka pasur 'të paktën' 25-30 individë të cilëve u është refuzuar kërkesa për dokumente identiteti.¹¹⁶ Në të njëjtën situatë janë një numër individësh në zonat në Osojan dhe rrethinë, si dhe pjesë të tjera të Kosovës me numër të lartë të të kthyerve. Një numër rastesh janë vënë në vëmendjen e shërbimeve të ndihmës juridike falas, si dhe të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, të cilët aktualisht janë duke punuar për të gjetur zgjidhjet e mundshme.

¹¹⁶ Bazuar në intervistën e realizuar me një aktivist të shoqërisë civile nga Gorazhdevci, në shtator të vitit 2022.

Në nivel botëror, viti 2021 u shënua me rimëkëmbje të ngadaltë ekonomike pas mbylljeve të COVID-19 dhe rritje të vazhdueshme të çmimeve të mallrave të konsumit që godasin portofolat e qytetarëve të Kosovës, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike. Ndonëse Qeveria e Kosovës, si shumë të tjera anëmbanë Evropës, ofroi pako të ndihmës ekonomike të orientuara drejt zbutjes së ndikimit financiar të pandemisë, kjo nuk arriti të lehtësojë goditjen ekonomike afatgjatë. Kosova ishte në pozitë tashmë të cenueshme, me shkallë të lartë të papunësisë, ku punësimi sporadik dhe puna në ekonominë "e hirtë" përbën sfida të frikshme, veçanërisht për të rinjtë. Komunitetet jo-shumicë të Kosovës, shumë prej të cilave janë në pozitë veçanërisht të vështirë për shkak të pozitës së tyre të dobët socio-politike, e përjetuan veçanërisht rëndë ndikimin e ekonomisë së tkurrur. Në thelb, performanca e dobët ekonomike e Kosovës në të shkuarën nënkuptoi se pandemia ishte shkatërrimtare për bizneset e saj, të cilat pësuan për shkak të mbylljeve dhe uljes së të hyrave tatimore.¹¹⁷

Sipas informacionit të mbledhur gjatë procesit të hulumtimit në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të serbëve, boshnjakëve, turqve, romëve, goranëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, ndikimi i përgjithshëm i përkeqësimit të klimës ekonomike (që pasoi pandeminë e COVID-19) u perceptua negativisht. Të intervistuarit dhe pjesëmarrësit e fokus grupeve theksuan se valët e pushimeve nga puna në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë kanë rrezikuar tutje mirëqenien e tyre financiare që tashmë ishte e rrezikuar. Për më tepër, ata i shihnin masat e ndihmës ekonomike si masa që nuk i merrnin parasysh nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë. Kjo krijoi një situatë ku shumë individë vëshin gjithnjë e më shumë nga ndihma e diasporës.¹¹⁸

At Në nivelin themelor, kjo nënkuptonte pakësim të kursimeve për shumë familje që ishin të varur nga flukset e të ardhurave që më parë ishin të kufizuara dhe shpesh të lidhura me të afërmit që jetonin jashtë vendit.¹¹⁹ Mund të argumentohet se një nga komunitetet më të prekura nga rënia ekonomike ishin pjesëtarët e komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, të cilët shpesh angazhohen në punë informale (grumbullim i lëndëve të papërpunuara dytësore, punë stinore, shitje mallrash në tregje të hapura), ndërkohë që të gjitha këto ishin të kufizuara gjatë pandemisë. Kjo rezultoi në një situatë ku pjesëtarët tashmë të varfër të këtyre komuniteteve u gjendën në vështirësi në rritje për shkak të pengesave në sigurimin e ushqimit, ujit, produkteve higjienike, si dhe në pagesën e shpenzimeve komunale dhe shpenzimeve të tjera.¹²⁰

¹¹⁷ Komisioni Evropian. *Raporti për Kosovën* 2021*. 2021. në dispozicion këtu: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Kosovo%202021%20report.PDF>

¹¹⁸ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet me pjesëtarë të komuniteteve serbe, gorane, boshnjake, turke dhe rome, ashkali dhe egjiptiane.

¹¹⁹ Po aty

¹²⁰ Bazuar në fokus grupet me pjesëtarë të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të realizuara ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

PROCESI I KTHIMIT

Niveli jashtëzakonisht i ulët i dinamikës së procesit të kthimit të personave të zhvendosur në Kosovë në dy dekadat e fundit është ndikuar nga një sërë faktorësh, ndër të cilët më domethënës janë mjedisi i pasigurt, marrëdhëniet e pazgjdhura pronësore-juridike, qasja e kufizuar në shërbime institucionale në gjuhën amtare, liria e kufizuar e lëvizjes, uzurpimi i pronës private dhe proceset gjyqësore financiarisht të shtrenjta dhe që kërkojnë kohë për t'ua kthyer pronat pronarëve fillestarë. Si një nga faktorët kyç që zmadhon periodikisht efektin e faktorëve të lartpërmendur është forcimi i shpeshtë i diskurseve nacionaliste që mund të vërehen në hapësirën publike në Kosovë, të cilat në mënyrë (in)direkte stigmatizojnë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, e me këtë edhe të kthyerit. Thirrjet për personat e zhvendosur që vijnë nga vendimmarrësit në nivelin qendror shpesh perceptohen si mesazhe të pasinqerta të shoqëruara me pohime që janë në kundërshtim me kufizimet dhe barrierat objektive që pengojnë kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve. Sipas të kthyerve, mbështetja institucionale për personat që kanë vendosur të kthehen në shtëpitë e tyre nuk është në përputhje me detyrimet e përcaktuara me ligj, sidomos kur bëhet fjalë për ato që janë nën juridiksionin e institucioneve lokale.¹²¹ Gjithashtu, ekziston një qëndrim i pabarabartë i autoriteteve individuale komunale ndaj të kthyerve që ndodhen në territorin e juridiksionit të tyre.

Grup posaçërisht të cënueshëm brenda komunitetit të të kthyerve përbëjnë ashkalinjtë, egjiptianët dhe romët, të cilët jetojnë në kushte veçanërisht të vështira jetese. Gjatë vitit 2021, disa komuna në Kosovë nuk ndanë tokën e premtuar më parë në komuna të tjera përveç atyre ku kanë lindur dhe ku kanë pasur pronë përpara daljes si refugjatë.¹²² Krahas këtij problemi, pjesëtarët e këtyre komuniteteve u ndeshën me problemin e qasjes në dokumente, arsim dhe shërbime, pas procesit të realizuar me sukses të kthimit në komunën ku kanë lindur apo komunën ku u është ndarë toka. Të kthyerit ishin gjithashtu cak i shpeshtë i diskriminimit verbal nga fqinjët.¹²³ Sipas pohimeve të përfaqësuesve parlamentarë të këtyre komuniteteve, faktorët e lartpërmendur kanë luajtur rol vendimtar në pamundësinë e kthimit të rreth 400 ashkalinjve, romëve dhe egjiptianëve gjatë vitit 2021, edhe pse ata kanë shprehur dëshirën e tyre për kthim dhe kanë njoftuar institucionet kompetente.¹²⁴

Procesi i kthimit në Kosovë tërhoqi veçanërisht vëmendjen e publikut vendas dhe rajonal pas kthimit të qytetares së nacionalitetit serb Dragica Gašić në vendlindjen e saj në Gjakovë. Pas vendimit të Agjencisë për Verifikimin dhe Krahasimin e Pronës, zonjës Gašić iu dha e drejta për t'ua kthyer në banesën që ishte uzurpuar në periudhën ndërmjet dëbimit dhe vendimit. Kthimi në banesën që ishte pronë e saj trazoi publikun në Gjakovë dhe për rrjedhojë pati reagim nga Organizata e Përfaqësuesve të Familjeve të Personave të Zhdukur dhe disa organizatave jo-qeveritare nga ky qytet, ku iu bë thirrje institucioneve

¹²¹ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

¹²² Departamenti Amerikan i Shtetit, *RAPORTI I VITIT 2021 PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË*, 2022, f. 18, në dispozicion këtu: https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf

¹²³ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

¹²⁴ Po aty

që të mos lejojnë zonjën Gašić të kthehet në banesën e saj.¹²⁵ Si rezultat i këtyre dhe thirrjeve të ngjashme, Komuna e Gjakovës inicioi procedurë civile kundër të kthyerës për shkak të uzurpimit të pretenduar të banesës,¹²⁶ të cilën Gjykata Themelore në Gjakovë e refuzoi si të pabazuar. Një dënim i rrallë për nisjen e këtij procesi gjyqësor erdhi nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut.¹²⁷ Megjithatë, reagimi publik i një numri më të vogël të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe misioneve diplomatike pasoi vetëm pas disa rasteve të frikësimit¹²⁸ dhe thyerjes dhe hyrjes¹²⁹ në banesën e zonjës Gašić.¹³⁰ Në rastin e fundit kanë reaguar institucionet dhe hajduti është arrestuar¹³¹. Nga ana tjetër, kryeministri Albin Kurti e ka keqpërdorur këtë rast dhe e ka shfrytëzuar në një paraqitje publike në kontekstin e akuzave ndaj Serbisë për gjenocid të pretenduar, gjë që rrezikoi edhe më tej sigurinë e së kthyerës.¹³²

Siç do të shpjegohet më tej në pjesën që trajton çështjen e sigurisë, praktika e presionit ndaj të kthyerëve të nacionalitetit serb në formë të sulmeve fizike dhe rrezikimit/vjedhjes së pronës private të të kthyerëve, veçanërisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021. Sipas pohimeve të të kthyerëve të intervistuar nga kjo pjesë e Kosovës, dhe përveç faktorëve të lartpërmendur, faktori kyç që demotivon dhe në të njëjtën kohë pengon kthimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe adekuat të personave të zhvendosur janë proceset gjyqësore me cilësi të mangët, përfshirë atë procedurale, dhe zvarritja e tepruar e tyre për përcaktimin e pronësisë së pronës së uzurpuar, gjë që në fund të fundit, “e bëri plotësisht të pakuptimtë procesin e kthimit”. Këto dhe një sërë problemesh të tjera janë parakusht për numrin ende të ulët të kthimeve, gjë që mbështetet nga fakti se gjatë vitit 2021, sipas të dhënave të UNHCR-së, vetëm 368 persona janë kthyer në Kosovë.¹³³

¹²⁵ Evropa e Lirë, *Dragica Gašić nepoželjna u Đakovici, Vlada Kosova čuti*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.slobodnaevropa.org/a/slucaj-dragica-gasic-djakovica-povratak-raseljena-lica/31331295.html>

¹²⁶ KosSev, *Opština Đakovica pokrenula parnični postupak protiv Dragice Gašić zbog „uzurpacije stana”*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/petkovic-opstina-djakovica-pokrenula-parnicni-postupak-protiv-dragice-gasic-zbog-navodne-uzurpacije-stana/>

¹²⁷ KosSev, *FHP i YIRH Kosova: Vlasti u Đakovici da povuku tužbu protiv Gašić, u suprotnosti je sa Ustavom*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/fhp-i-yirh-kosova-vlasti-u-djakovici-da-povuku-tuzbu-protiv-gasic-u-suprotnosti-je-sa-ustavom/>

¹²⁸ Balkan Insight, *Vidhet shtëpia e serbes më të famshme të rikthyer në Kosovë*, 2021, në dispozicion këtu: <https://balkaninsight.com/sq/2021/07/28/vidhet-shtepia-e-serbes-me-te-famshme-te-rikthyer-ne-kosove/>

¹²⁹ KosSev, *Kancelarija za KiM: Dragici Gašić obijen i ispreturan stan, ukradeni nadzorna kamera i ruter*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kancelarija-za-kim-dragici-gasic-obijen-i-ispreturaan-stan-ukradeni-nadzorna-kamera-i-ruter/>

¹³⁰ Në periudha të ndryshme, në lidhje me rastin e zonjës Gašić u deklaruan publikisht dhe dënuan trajtimin diskriminues ndaj të kthyerës subjektet në vijim: OSBE në Kosovë, ambasadat e SHBA-së, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe në Kosovë, Avokati i Popullit (Ombudspersoni), deputetja Mimoza Kusari Lila.

¹³¹ Evropa e Lirë, *Arrestohet personi që theu banesën e Dragica Gashiqit*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.evropaelire.org/a/arrestim-tyerja-e-baneses-se-dragica-gashiqit-/31387053.html>

¹³² KosSev, *Kurti u Briselu: Srbija je došla na Kosovo genocidom i otišla sa genocidom, Vučić zloupotrebjava Dragicu*, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/kurti-u-briselu-srbija-je-dosla-na-kosovo-genocidom-i-otisla-sa-genocidom-vucic-zloupotrebjava-dragicu/>

¹³³ Balkan Insight, *Refugjatja serbe rikthehet në shtëpinë e saj në Kosovë, 22 vjet pasi u largua që aty*, 2021, në dispozicion këtu: <https://balkaninsight.com/sq/2022/03/02/refugjatja-serbe-rikthehet-ne-shtepine-e-saj-ne-kosove-22-vjet-pasi-u-largua-qe-aty/>

VI. IDENTITETI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Çështjet e identitetit dhe trashëgimisë kulturore në Kosovë janë shumë shpesh çështje të ngarkuara, pasi ato janë përdorur si armë, në të shkuarën, si pjesë e betejave më të mëdha narrative mbi historinë dhe territorin, shpesh në kontekstin e mohimeve më të gjera të pretendimeve për kontroll mbi monumentet historike. Pavarësisht kësaj, korniza legjislative e Kosovës ofron garanci për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtën e komuniteteve për të zhvilluar lirisht dhe për të nxitur ndjenjën e identitetit etnik.

Gjatë gjithë vitit 2021, në skenën politike të Kosovës vazhduan të vlojnë debatet në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të lidhur me komunitetet jo-shumicë të Kosovës. Së pari dhe më kryesorja, vendimi i 'Europa Nostra' për të shtuar Manastirin e Deçanit në listën e shtatë monumenteve 'më të rrezikuara' shkaktoi reagime të ashpra,¹³⁴ ku aktorë politikë që përfaqësojnë komunitetin shqiptar të Kosovës, së bashku me disa organizata joqeveritare, e dënuan këtë veprim. Gjithashtu, për sa i përket Manastirit të Deçanit, autoritetet komunale vazhduan të refuzojnë t'i binden vendimit të Gjykatës Kushtetuese që i kishte urdhëruar ata të kthenin tokën që i përket Kishës Ortodokse Serbe,¹³⁵ që do të thotë se konflikti është i vazhdueshëm dhe i pazgjidhur në kohën e publikimit të këtij raporti. Më tej, kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka deklaruar kategorikisht se do ta shpërfillë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndonëse legjislacioni i Kosovës ofron mbrojtje të gjerë për objektet e kultit, gatishmëria e autoriteteve, veçanërisht në nivelin e qeverisjes lokale, për të zbatuar legjislacionin përkatës shpesh vihet në pikëpyetje nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë organet ndërkombëtare të përkushtuara për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Menjëherë pas publikimit të listës nga Europa Nostra, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë (KMDLNJ) bëri një sërë akuzash kundër igumenit të Manastirit të Deçanit, Atit Sava Janjić, duke deklaruar se ai është një kriminel 'i mundshëm' luftime dhe se ai mund të ketë marrë pjesë në shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë konfliktit të fundit të viteve 1990.¹³⁶ Kjo nxiti reagim nga organizatat joqeveritare dhe mediat në komunitetet serbe të Kosovës, të cilët i dënuan akuzat si të pabaza.¹³⁷

¹³⁴ Europa Nostra, *Inclusion of the Dečani Monastery on the 2021 List of 7 Most Endangered heritage sites in Europe*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.europanostra.org/inclusion-of-the-decani-monastery-on-the-2021-list-of-7-most-endangered-heritage-sites-in-europe/>

¹³⁵ KosSev, „Ali Hadri” protiv poziva američkog ambasadora da Ustavni sud primeni odluku o povraćaju zemlje manastiru, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/udruzenje-istoricara-iz-decana-manastir-da-se-izvini-za-genocid-spc-i-srbije-pre-nego-sto-trazi-imovinu/>

¹³⁶ KosSev, CDHRF from the „burning” of Albanians in Trepca in 1999, through to March 17th, to Fr. Sava as a „possible” war criminal, 2021, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/cdhrf-from-the-burning-of-albanians-in-trepca-in-1999-through-to-march-17th-to-fr-sava-as-a-possible-war-criminal/>

¹³⁷ OJQ AKTIV, *Njoftime për shtyp*, 2021, në dispozicion këtu: <http://ngoaktiv.org/alb/news/press-release>

Gjatë vitit 2021, OJQ AKTIV regjistroi gjithsej njëzet e katër (24) incidente (të natyrës kriminale) që përfshinin dëmtim, vandalizëm dhe/ose vjedhje të pronës që i përkiste Kishës Ortodokse Serbe (KOS), që ndodhi, në përgjithësi, në komunitete më të vogla dhe më të izoluara. Në shënjestër nuk ishin vetëm kishat; një numër sulmesh të shkallëve dhe natyrave të ndryshme u kryen kundër xhamive dhe një kisha katolike, me motivin shpeshherë financiar (p.sh., vjedhja e kutisë së donacioneve nga një xhami në Kaçanik.)¹³⁸ Po ashtu, edhe Policia e Kosovës ka shënuar rritje të numrit të incidenteve që kanë pasur për cak objektet fetare (nga 56 në vitin 2020 në 87 në vitin 2021), prej të cilave 56 kanë pasur cak objektet fetare islame, 30 objekte fetare të KOS dhe një objekt fetar katolik.¹³⁹

Kur bëhet fjalë për çështjet e trashëgimisë kulturore jo-materiale, siç është identiteti etno-kombëtar, situata është disi më e turbullt. Disa pjesëtarë të komunitetit goran shprehën mendimin se ndjenja e tyre e kombësisë shpesh mohohet dhe/ose shpërfillet, dhe së këndejmi trashëgimia e tyre kulturore kolektive nënvlerësohet.¹⁴⁰ Në mënyrë të ngjashme, disa pjesëtarë të komunitetit turk të Kosovës përmendën vështirësitë lidhur me përpjekjet për të krijuar një qendër kulturore në Prizren si një shembull të çështjeve më të gjera me të cilat ballafaqohen kur bëhet fjalë për promovimin dhe ruajtjen e kulturës dhe historisë së tyre.¹⁴¹

¹³⁸ Departamenti Amerikan i Shtetit, *RAPORTI I VITIT 2021 PËR LIRITË FETARE NDËRKOMBËTARE: KOSOVA, 2021*, f. 13, në dispozicion këtu: https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/IRF2021_Alb.pdf

¹³⁹ Po aty

¹⁴⁰ Bazuar në fokus grupet me pjesëtarë të komunitetit goran dhe turk të realizuara ndërmjet gushtit dhe tetorit 2022.

¹⁴¹ Po aty

VII. SMALLER NON-MAJORITY COMMUNITIES

Ndryshe nga punimet kërkimore të natyrës së ngjashme, duke filluar me publikimin e Vlerësimit të statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë për vitin 2020, OJQ AKTIV ka analizuar problemet dhe interesat e komuniteteve më të vogla jo-shumicë, përkatësisht komunitetit hebraik, kroat dhe malazez. Për sa i përket problemeve me të cilat ballafaqohen këto komunitete në Kosovë, gjatë vitit në shqyrtim 2021, nuk ka pasur zhvillime të dukshme pozitive në lidhje me vlerësimin e gjendjes së respektimit të të drejtave të tyre, të cilat janë theksuar në publikimin e lartpërmendur.¹⁴² Përkundër faktit se komunitetet në fjalë janë më të vogla për nga numri, pengesat dhe problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e tyre në Kosovë meritojnë vëmendje të veçantë, veçanërisht në dritën e interesimit më të vogël të institucioneve të pushtetit lokal dhe qendror për dinamikën e përmirësimit të të drejtave dhe kushteve të jetesës, si dhe mungesën e formalizimit legjislativ të statusit të tyre.

Me qëllim zgjidhjen e problemeve të ngutshme për pjesëtarët e **komunitetit malazez**, Shoqata e Malazezëve të Kosovës i ka dërguar një shkresë zyrtare Qeverisë në fund të marsit 2021, në të cilën është shprehur kërkesa për krijimin sa më shpejt të jetë e mundur të një plani veprimi për procesin e zbatimit të *Strategjisë për afirmimin dhe integrimin e komunitetit malazez*, e cila u miratua në vitin 2016.¹⁴³ Thirrja lindi nga fakti se institucionet përkatëse nuk e kishin trajtuar këtë propozim dhe periudha që mbulon strategjia (2016-2021) në të vërtetë ka skaduar. Sipas pohimeve të bashkëbiseduesve nga ky komunitet, momentum i mund të ishte krijuar me adoptimin zyrtar të Strategjisë, në periudhën aktuale do të kontribuonte, edhe pse në masë të kufizuar, në përmirësimin e respektimit të të drejtave të këtij komuniteti përmes procesit të formalizimit ligjor. Fakti që një organizatë tjetër që angazhohet për interesat e këtij komuniteti, Unioni i Malazezëve të Kosovës, i ka bërë thirrje zëvendëskryeminstres përgjegjëse për komunitetet jo-shumicë, Emilija Redžepi, që të fillojë sa më shpejt zbatimin e Strategjisë, tregon se ky është hap tejet i rëndësishëm për malazezët e Kosovës. Në takimin e zonjës Redžepi dhe kryetarit të Shoqatës së Malazezëve Lloqen, u theksua se është e nevojshme përfshirja e një (1) përfaqësuesi të këtij komuniteti, i cili do të punonte në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Qeverinë për të zgjidhur gradualisht sfidat kryesore me të cilat përballlet ky komunitet në bazë ditore. Megjithatë, temat si respektimi i të drejtave gjuhësore, të drejtat e të kthyerve, kushtet socio-ekonomike të jetesës, qasja në shërbime, dokumente dhe arsimim, si dhe ruajtja e identitetit kulturor, nuk gjetën vend në krye të agjendës së institucioneve dhe së këndejmi kërkesat e lartpërmendura mbetën të shpërfillura.

¹⁴² NGO AKTIV, *Evaluation of the state of the rights of minorities in Kosovo (2020)*, 2021, pg. 69-73, available at: [http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo\(Srb\)web.pdf](http://ngoaktiv.org/uploads/files/Kosovo(Srb)web.pdf)

¹⁴³ Kosovo Online, *Montenegrin Association of Kosovo calls on Kurti to arrange their formal and legal status*, 2021, available at: <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/udruzenje-crnogoraca-pozvalo-kurtija-da-uredi-njihov-formalno-pravni-polozaj-24-3>

¹⁴⁴ Info-KS, *INTEGRATION AND AFFIRMATION OF A COMMUNITY Montenegrin Union in Kosovo send open letter to Emilia Rexepi*, 2021, dostupno na: <https://www.info-ks.net/vijesti/kosovo/124145/unija-crnogoraca-na-kosovu-uputila-otvoreno-pismo-emiliji-redzepin>

¹⁴⁵ RTK2, *Representative of the Montenegrin community should be a part of the government*, 2021, available at: <https://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=64963>

Gjatë vitit të analizuar, **komuniteti kroat** u përball me probleme ende aktuale dhe kyçe: gjendja e keqe socio-ekonomike, tendencat migratore dhe mungesa e angazhimit të konsiderueshëm institucional në zgjidhjen e tyre. Popullata në zonat e banuara nga ky komunitet e vlerësoi pozitivisht interesimin (si dhe vizitat gjithnjë e më të shpeshta të zyrtarëve) të Republikës së Kroacisë për aktualizimin dhe zgjidhjen e disa pengesave që qëndrojnë në rrugën e integritit të plotë në shoqërinë kosovare.¹⁴⁶ Krahas kësaj, veçanërisht pozitivisht u vlerësua fillimi i procesit të revitalizimit dhe restaurimit të trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore në vendbanimet e kroatëve në Letnicë¹⁴⁷ dhe Janjevë.¹⁴⁸ Përkundër kësaj, përfaqësues të shquar të këtij komuniteti gjatë hulumtimit theksuan se gjendja aktuale është alarmante për shkak të valëve të mëdha të migrimit nga Kosova, si dhe qëndrimit të vetëm shtresave më të vjetra dhe shpeshherë të cenushme sociale. Në mbështetje të këtij pretendimi dalin edhe deklaratat e përfaqësuesve të komunitetit nga Janjeva, të cilët theksuan se numri aktual i kroatëve të Kosovës në Janjevë është reduktuar në 160 si numër rekord i ulët.¹⁴⁹ Për më tepër, si në vitet dhe tri dekadat e shkuara, çështja e sigurisë personale dhe pronësore në radhë të parë përcakton dhe kushtëzon vendimin e popullatës vendase në favor të shpërnguljes nga Kosova.¹⁵⁰

Pjesëtarët e komunitetit hebraik përshëndetën shpalljen e hapjes së ambasadës së Izraelit si hap që do të kontribuojë dukshëm në mbrojtjen e trashëgimisë së tyre kulturore në Kosovë, si dhe në kujdesin më intensiv për interesat dhe mbijetesën e këtij komuniteti më të paktë për nga numri¹⁵¹.

¹⁴⁶ Ministarstvo obrane, *Posjet ministra Banožića hrvatskoj zajednici u Janjevu*, 2021, në dispozicion këtu:

<https://www.morh.hr/posjet-ministra-banozica-hrvatskoj-zajednici-u-janjevu/>

¹⁴⁷ UNDP, *BREATHING NEW LIFE Restoring cultural heritage in Letnicë/Letnica*, 2021, në dispozicion këtu: <https://undpkosovo.exposure.co/breathing-new-life>

¹⁴⁸ RTV KIM, *Janjevo: EU ulaže dva miliona evra u turizam i očuvanje kulturnog nasleđa*, 2021, në dispozicion këtu: <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/janjevo-eu-ulaže-dva-miliona-evra-u-turizam-i-ocuvanje-kulturnog-nasledja.html>

¹⁴⁹ HRT: Glas Hrvatske, *U Janjevu ostalo samo 160 Hrvata*, 2021, në dispozicion këtu: <https://glashrvatske.hrt.hr/hr/izvan-domovine/u-janjevu-ostalo-samo-160-hrvata-3773566>

¹⁵⁰ Bazuar në intervistat dhe fokus grupet e realizuara për qëllimet e këtij kërkimi në periudhën nga gushti deri në tetor 2022.

¹⁵¹ Po aty

VIII. THREE KEY INTERESTS OF EVERY NON-MAJORITY COMMUNITY

Boshnjakët

1. Patjetër duhet të përmirësohet cilësia e arsimit në gjuhën boshnjake përmes sigurimit pa probleme të teksteve shkollore dhe zgjerimit të ofertës së katedrave të studimit në universitete (kryesisht në Prizren dhe Pejë) për të zhvilluar potencialin e komunitetit boshnjak në Kosovë. Përveç kësaj, është e nevojshme të përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara në gjuhën boshnjake nga institucionet në nivel lokal dhe qendror.
2. Përmirësimi i situatës ekonomike duke ofruar subvencione për fermerët dhe bizneset.
3. Rritja e pranisë së punonjësve të policisë në fshatrat e rajonit të Zhupës dhe Podgorës.

Goranët

1. Forcimi i komponentit ekonomik dhe luftimi i papunësisë në radhët e pjesëtarëve të komunitetit goran, kryesisht përmes kapërcimit të barrierës gjuhësore si problem kyç i konkurrencës në tregun e punës në Kosovë. Kjo vlen edhe për qasjen në shërbime institucionale dhe komunikimin me nëpunësit në gjuhën amtare.
2. Krijimi i kushteve të qëndrueshme për parandalimin e migrimit të pjesëtarëve të komunitetit goran dhe largimit nga Gora.
3. Mundësimi i qasjes në arsim për pjesëtarët më të rinj të komunitetit goran, si parakusht për integrim të plotë në shoqërinë kosovare.

Hebrenjtë

1. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore të hebrenjve të Kosovës.
2. Mundësimi i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komunitetit hebraik në punën e organeve që merren me çështjet e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë (si Këshilli Konsultativ për Komunitete).
3. Jetësimi i planit ekzistues për ndërtimin/renovimin e sinagogave në Kosovë.

Kroatët

1. Krijimi i një kornize të qëndrueshme për përfaqësimin politik të interesave të komunitetit kroat të Kosovës në nivel qendror dhe lokal, përmes njohjes së tij zyrtare si komunitet jo-shumicë në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse.
2. Trajtimi i problemit të papunësisë së lartë, veçanërisht në mesin e pjesëtarëve të gjeneratave të reja të kroatëve të Kosovës.
3. Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve të ofruara për pjesëtarët e gjeneratës së vjetër të kroatëve të Kosovës.

Malazezët

1. Përcaktimi i numrit të pjesëtarëve të komunitetit malazez në Kosovë, me qëllim të rritjes dhe forcimit të mbështetjes dhe zhvillimit institucional.
2. Ndërmarrja e aktiviteteve afirmative për komunitetin malazez që jeton në Kosovë, me theks të veçantë në ruajtjen dhe përmirësimin e pozitës dhe identitetit gjithëpërfshirës.
3. Promovimi dhe integrimi i plotë i komunitetit malazez në shoqërinë kosovare dhe barazimi me komunitetet tjera jo-shumicë në Kosovë.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët

1. Përfshirja e barabartë dhe e plotë e pjesëtarëve të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në procesin e punësimit dhe ofrimi gjithëpërfshirës i qasjes në shërbime shëndetësore, arsimore dhe të tjera publike, si faktorë kyç për integrimin në shoqërinë kosovare.
2. Forcimi i mekanizmave institucionalë në luftën kundër diskriminimit si problem kyç në realizimin e të drejtave themelore të njeriut të pjesëtarëve të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.
3. Mundësimi i mësimin të gjuhës rome si gjuhë fakultative në institucionet arsimore me prani të konsiderueshme të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.

Serbët

1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal do të duhej të përmirësojnë kushtet e sigurisë së jetës për serbët e Kosovës, veçanërisht ata që jetojnë në jug të lumit Ibër. Kjo nënkupton procedimin e rasteve të veprave penale që rrezikojnë sigurinë private dhe pronësore, si dhe dënimin publik të incidenteve nga zyrtarë të nivelit qendror dhe vendor.
2. Të mundësohet kthimi i qëndrueshëm i serbëve të zhvendosur në Kosovë, së bashku me ndryshime sistematike në procesin e zgjidhjes së kontesteve pronësore-juridike në rastet e pronave të uzurpuara.
3. Të ofrohet mbrojtja dhe siguria e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.

Turqit

1. Pjesëtarëve të komunitetit turk do të duhej t'u ofrohet arsim më i mirë në gjuhën turke, veçanërisht në nivelin e arsimit të lartë. Gjithashtu, është e nevojshme të sigurohet mësimi i gjuhës shqipe për pjesëtarët e këtij komuniteti në të gjitha nivelet e arsimit.
2. Zgjidhja sistematike e problemit të papunësisë të gjeneratave të reja të turqve të Kosovës, me qëllim të parandalimit të migrimit në rritje të rinjve nga Kosova nga ky komunitet.
3. Angazhime më të mëdha nga institucionet lokale dhe qendrore në ruajtjen e kulturës dhe gjuhës së turqve të Kosovës, p.sh., përmes ndërtimit të Qendrës Kulturore Turke të paralajmëruar prej kohësh.



QJQ AKTIV
NËNTOR 2022